



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ANALIZA E TREGUT PËR SEKTORIN E PERIMEVE 2021 - 2023



Analiza e tregut për sektorin e perimeve 2021-2023

Tetor, 2025

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave.....	4
Lista e figurave.....	5
Lista e shkurtesave	8
Hyrje	9
Metodologjia	10
Përmbledhje	11
1 Prodhimtaria e sektorit të perimeve	12
1.1 Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i perimeve	12
1.2 Kulturat perimtare më të kultivuara	14
1.2.1 Patate	15
1.2.2 Spec.....	15
1.2.3 Fasule	16
1.2.4 Kungull	16
1.2.5 Qepë	17
1.2.6 Shalqi.....	18
1.2.7 Lakër.....	18
1.2.8 Kungull misiri	19
1.2.9 Domate.....	19
1.2.10 Trangull.....	20
2 Tregtia për sektorin e perimeve.....	21
2.1 Eksporti dhe importi i kulturave perimtare.....	23
2.1.1 Eksporti dhe importi i patates.....	26
2.1.2 Eksporti dhe importi i specit.....	31
2.1.3 Eksporti dhe importi i fasules.....	34
2.1.4 Eksporti dhe importi i kungullit dhe kungullit të misirit	38
2.1.5 Eksporti dhe importi i qepës.....	42
2.1.6 Eksporti dhe importi i shalqirit.....	45
2.1.7 Eksporti dhe importi i lakrës.....	49
2.1.8 Eksporti dhe importi i domates	53
2.1.9 Eksporti dhe importi i trangullit.....	56
3 Çmimet e kulturave perimtare.....	61
3.1 Çmimet për kulturën e patates	62
3.2 Çmimet për kulturën e specit.....	62
3.3 Çmimet për kulturën e fasules.....	63
3.4 Çmimet për kulturën e kungullit.....	63
3.5 Çmimet për kulturën e qepës.....	64
3.6 Çmimet për kulturën e shalqirit	64
3.7 Çmimet për kulturën e lakrës	65
3.8 Çmimet për kulturën e kungullit të misirit	65
3.9 Çmimet për kulturën e domates.....	66
3.10 Çmimet për kulturën e trangullit	66
4 Mbështetja direkte për sektorin e perimeve	67

4.1	Mbështetja direkte për pataten	69
4.2	Mbështetja direkte për specin	70
4.3	Mbështetja direkte për fasulen.....	71
4.4	Mbështetja direkte për kungullin	73
4.5	Mbështetja direkte për qepën.....	74
4.6	Mbështetja direkte për shalqirin.....	75
4.7	Mbështetja direkte për lakrën	76
4.8	Mbështetja direkte për kungullin e misirit	76
4.9	Mbështetja direkte për domaten.....	77
4.10	Mbështetja direkte për trangullin.....	78
4.11	Mbështetja përmes granteve për sektorin e perimeve	79
5	Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi	82
5.1	Plotësimi i nevojave vendore me kultura perimtare.....	82
5.1.1	Plotësimi i nevojave vendore për kulturat perimtare më të kultivuara	83
5.2	Konsumi për kokë banori	89
	Konkluzionet.....	91
	Shtojca	93

Lista e tabelave

Tabela 1:	Sipërfaqja e kulturave perimtare 2021-2023, në ha	12
Tabela 2:	Prodhimi i kulturave perimtare 2021-2023, në tonë	13
Tabela 3:	Rendimenti i kulturave perimtare 2021-2023, në tonë/ha	14
Tabela 4:	Eksporti dhe importi për perime (kodin doganor 07)	21
Tabela 5:	Eksporti i kulturave perimtare	23
Tabela 6:	Importi i kulturave perimtare	25
Tabela 7:	Eksporti dhe importi i patates	27
Tabela 8:	Eksporti dhe importi i specit	31
Tabela 9:	Eksporti dhe importi i fasules	35
Tabela 10:	Eksporti dhe importi i kungullit dhe kungullit të misirit	39
Tabela 11:	Eksporti dhe importi i qepës	42
Tabela 12:	Eksporti dhe importi i shalqirit	46
Tabela 13:	Eksporti dhe importi i lakrës	49
Tabela 14:	Eksporti dhe importi i domates	53
Tabela 15:	Eksporti dhe importi i trangullit	57
Tabela 16:	Çmimet e kulturave perimtare 2022-2023	61
Tabela 17:	Pagesat direkte për sektorin e perimeve 2022-2023	68
Tabela 18:	Pagesa direkte për pataten, 2021-2023	70
Tabela 19:	Pagesa direkte për spec, 2021-2023	71
Tabela 20:	Pagesa direkte për fasule, 2021-2023	72
Tabela 21:	Pagesa direkte për kungull, 2021-2023	73
Tabela 22:	Pagesa direkte për qepë, 2021-2023	74
Tabela 23:	Pagesa direkte për shalqi, 2021-2023	75
Tabela 24:	Pagesa direkte për lakër, 2021-2023	76
Tabela 25:	Pagesa direkte për kungull misiri, 2021-2023	77
Tabela 26:	Pagesa direkte për domate, 2021-2023	78
Tabela 27:	Pagesa direkte për trangull, 2021-2023	79
Tabela 28:	Projektet e miratuara nga PZHR për sektorin e perimeve, 2023	80
Tabela 29:	Vendet e punës të krijuara në sektorin e perimtarisë, PZHR 2023	81
Tabela 30:	Të dhëna për disa nga treguesit e gjeneruar nga PZHR 2023	81
Tabela 31:	Lista e kodeve doganore (8 shifrore) të përfshira në analizë tek kapitulli i tregtisë	93

Lista e figurave

Figura 1:	Renditja e kulturave perimtare sipas sipërfaqes së kultivuar për tri vitet e fundit	15
Figura 2:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i patates	15
Figura 3:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i specit	16
Figura 4:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i fasules	16
Figura 5:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kungullit	17
Figura 6:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i qepës	17
Figura 7:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i shalqirit	18
Figura 8:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i lakrës	18
Figura 9:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kungullit të misirit	19
Figura 10:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i domates	19
Figura 11:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i trangullit	20
Figura 12:	Pjesëmarrja e vlerës së importit dhe eksportit të perimeve (kodi doganor 07), në vlerën e importit dhe eksportit të produkteve bujqësore (kodet doganore 01-24)	22
Figura 13:	Eksporti, importi dhe bilanci tregtar për perime (kodi doganor 07), në '000 €	22
Figura 14:	Vlera e eksportit të kulturave perimtare, në %	24
Figura 15:	Vlera e importit të kulturave perimtare, në %	26
Figura 16:	Eksporti i patates 2021-2023	27
Figura 17:	Eksporti i patates sipas muajve, në '000 €	28
Figura 18:	Eksporti i patates sipas shteteve	29
Figura 19:	Importi i patates 2021-2023	29
Figura 20:	Importi i patates sipas muajve, në '000 €	30
Figura 21:	Importi i patates sipas shteteve	30
Figura 22:	Eksporti i specit 2021-2023	32
Figura 23:	Eksporti i specit sipas muajve, në '000 €	32
Figura 24:	Eksporti i specit sipas shteteve	33
Figura 25:	Importi i specit 2021-2023	33
Figura 26:	Importi i specit sipas muajve, në '000 €	34
Figura 27:	Importi i specit sipas shteteve	34
Figura 28:	Eksporti i fasules 2021-2023	36
Figura 29:	Eksporti i fasules sipas muajve, në '000 €	36
Figura 30:	Eksporti i fasules sipas shteteve	37
Figura 31:	Importi i fasules 2021-2023	37
Figura 32:	Importi i fasules sipas muajve, në '000 €	38
Figura 33:	Importi i fasule sipas shteteve	38
Figura 34:	Eksporti i kungullit dhe kungullit të misirit 2021-2023	39
Figura 35:	Eksporti i kungullit dhe kungullit të misirit sipas muajve, në '000 €	40
Figura 36:	Eksporti i kungullit dhe kungullit të misirit sipas shteteve	40
Figura 37:	Importi i kungullit dhe kungullit të misirit 2021-2023	41
Figura 38:	Importi i kungullit dhe kungullit të misirit sipas muajve, në '000 €	41
Figura 39:	Importi i kungullit dhe kungullit të misirit sipas shteteve	42

Figura 40:	Eksporti i qepës 2021-2023	43
Figura 41:	Eksporti i qepës sipas muajve, në '000 €.....	43
Figura 42:	Eksporti i qepës sipas shteteve	44
Figura 43:	Importi i qepës 2021-2023.....	44
Figura 44:	Importi i qepës sipas muajve, në '000 €	45
Figura 45:	Importi i qepës sipas shteteve.....	45
Figura 46:	Eksporti i shalqirit 2021-2023	46
Figura 47:	Eksporti i shalqirit sipas muajve, në '000 €	47
Figura 48:	Eksporti i shalqirit sipas shteteve.....	47
Figura 49:	Importi i shalqirit 2021-2023	48
Figura 50:	Importi i shalqirit sipas muajve, në '000 €.....	48
Figura 51:	Importi i shalqirit sipas shteteve	49
Figura 52:	Eksporti i lakrës 2021-2023	50
Figura 53:	Eksporti i lakrës sipas muajve, në '000 €	50
Figura 54:	Eksporti i lakrës sipas shteteve.....	51
Figura 55:	Importi i lakrës 2021-2023	51
Figura 56:	Importi i lakrës sipas muajve, në '000 €.....	52
Figura 57:	Importi i lakrës sipas shteteve	52
Figura 58:	Eksporti i domates 2021-2023.....	54
Figura 59:	Eksporti i domates sipas muajve, në '000 €.....	54
Figura 60:	Eksporti i domates sipas shteteve	55
Figura 61:	Importi i domates 2021-2023	55
Figura 62:	Importi i domates sipas muajve, në '000 €	56
Figura 63:	Importi i domates sipas shteteve.....	56
Figura 64:	Eksporti i trangullit 2021-2023	58
Figura 65:	Eksporti i trangullit sipas muajve, në '000 €	58
Figura 66:	Eksporti i trangullit sipas shteteve.....	59
Figura 67:	Importi i trangullit 2021-2023	59
Figura 68:	Importi i trangullit sipas muajve, në '000 €.....	60
Figura 69:	Importi i trangullit sipas shteteve	60
Figura 70:	Çmimet për patate në €/kg, 2021-2023.....	62
Figura 71:	Çmimet për specin në €/kg, 2021-2023	62
Figura 72:	Çmimet për fasulen në €/kg, 2021-2023.....	63
Figura 73:	Çmimet për kungullin në €/kg, 2021-2023	63
Figura 74:	Çmimet për qepën në €/kg, 2021-2023	64
Figura 75:	Çmimet për shalqi në €/kg, 2021-2023	64
Figura 76:	Çmimet për lakër në €/kg, 2021-2023.....	65
Figura 77:	Çmimet për kungull të misirit në €/kg, 2021-2023	65
Figura 78:	Çmimet për domate në €/kg, 2021-2023	66
Figura 79:	Çmimet për tranguj në €/kg, 2021-2023.....	66
Figura 80:	Pjesëmarrja e kulturave perimtare në gjithsej pagesat direkte	68
Figura 81:	Shpërndarja e pagesave direkte sipas kulturave perimtare (%).....	69

Figura 82:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për patate.....	70
Figura 83:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për spec.....	71
Figura 84:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për fasule	72
Figura 85:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për kungull.....	73
Figura 86:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për qepë	74
Figura 87:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për shalqi	75
Figura 88:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për lakër	76
Figura 89:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për kungull misiri.....	77
Figura 90:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për domate.....	78
Figura 91:	Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për trangull.....	79
Figura 92:	Furnizimi me kultura të perimeve, 2021-2023	82
Figura 93:	Furnizimi me patate, 2021-2023	83
Figura 94:	Furnizimi me spec, 2021-2023	84
Figura 95:	Furnizimi me fasule, 2021-2023	85
Figura 96:	Furnizimi me kungull dhe kungull misiri, 2021-2023	85
Figura 97:	Furnizimi me qepë, 2021-2023	86
Figura 98:	Furnizimi me shalqi, 2021-2023	86
Figura 99:	Furnizimi me lakër, 2021-2023.....	87
Figura 100:	Furnizimi me domate, 2021-2023.....	88
Figura 101:	Furnizimi me trangull, 2021-2023.....	88
Figura 102:	Konsumi i perimeve për kokë banori, 2021-2023	89
Figura 103:	Konsumi i perimeve sipas kulturave, 2021-2023	90

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AZHB	Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë
DAESB	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
OE	Operator Ekonomik
PPD	Programi i Pagesave Direkte
PRE	Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike
PZHR	Programi për Zhvillimin Rural

Hyrje

Analiza e gjendjes aktuale të sektorit të perimtarisë përmes të dhënave statistikore të përmbledhura paraqet një komponent kyç në procesin e formulimit të politikave bujqësore dhe zhvillimore. Ajo luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në evidentimin e progresit të arritur dhe tendencave të zhvillimit në këtë sektor, por gjithashtu në identifikimin e sfidave ekzistuese dhe përcaktimin e prioritetëve për mbështetje në të ardhmen.

Në Kosovë, sektori i perimtarisë përbën një pjesë të rëndësishme të bujqësisë dhe ekonomisë rurale, dhe për këtë arsye është subjekt i përkrahjes institucionale përmes dy instrumenteve kryesore të mbështetjes: Programit për Pagesa Direkte dhe Programit për Zhvillim Rural. Duke marrë parasysh këtë mbështetje, është me rëndësi të veçantë që të vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme ndikimi i politikave ekzistuese në rritjen e prodhimtarisë, përmirësimin e cilësisë së prodhimit, zhvillimin e infrastrukturës përpunuese dhe përmirësimin e kapaciteteve të shpërndarjes së produkteve në treg.

Në fokus të veçantë të analizës janë dhjetë kulturat perimtare më të kultivuara në vend, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të prodhimit dhe konsumit vendor. Për secilën nga këto kultura ofrohet një pasqyrë e detajuar mbi ecurinë e prodhimit, eksportin dhe importin, çmimet, mbështetjen direkte, mbështetjen e investimeve si dhe shkallën e plotësimit të nevojave vendore dhe konsumin për kokë banori. Gjithashtu, përmes kësaj analize synohet të nxirren rekomandime konkrete për politikat mbështetëse dhe për ndërhyrjet që mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrues të këtij sektori.

Metodologjia

Synimi i këtij publikimi është të paraqesë një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në sektorin e perimtarisë në Kosovë për periudhën 2021-2023, duke u fokusuar në dhjetë kulturat më të kultivuara në nivel vendi, bazuar në analizën e të dhënave statistikore.

Burimet e të dhënave të përdorura në këtë analizë janë: Të dhëna nga Agjencia e Statistikave të Kosovës¹, të dhëna nga DAESB lidhur me çmimet e kulturave bujqësore² dhe të dhëna nga AZhB³. Të gjitha këto të dhëna janë përpunuar dhe analizuar nga DAESB. Analiza përmban pesë kapituj kryesor dhe secili kapitull i kësaj analize përmban në detaje të dhënat, si:

Kapitulli 1: Prodhimtaria e sektorit të perimeve, janë të paraqitura të dhënat lidhur me sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e kulturave perimtare. Aty analizohet pjesëmarrja e perimeve si dhe ndryshimet e ndodhura mes viteve, dhe vëmendje e veçantë i kushtohet 10 kulturave perimtare që kultivohen në sipërfaqen më të madhe në Kosovë.

Kapitulli 2: Tregtia për sektorin e perimeve, prezanton të dhënat lidhur me tregtinë e jashtme të kulturave perimtare, ku analizohet eksporti dhe importi si total, sipas muajve dhe sipas shteteve me një vëmendje më të theksuar tek 10 kulturat perimtare më të kultivuara në Kosovë.

Kapitulli 3: Çmimet e kulturave perimtare, paraqiten çmimet për 10 kulturat perimtare më të kultivuara në Kosovë në nivel të fermës, në nivel të shitjes me shumicë dhe në nivel të shitjes me pakicë.

Kapitulli 4: Mbështetja për sektorin e perimtarisë, janë të paraqitura të dhënat e pagesave direkte/subvencioneve për sektorin e perimeve, duke përfshirë mbështetjen direkte për hektarë të kultivuar, për sipërfaqe me perime organike si dhe për pleh (patate dhe fasule) dhe naftë. Këtu analizohet numri i aplikuesve, numri i përfituesve, numri i njësi të subvencionuara, pagesa për njësi të subvencionuar si dhe gjithsej shuma e subvencionimit. Gjithashtu janë të paraqitura edhe të dhëna lidhur me grantet investive për nënmasat e ndërlidhura me sektorin e perimeve (numri i aplikuesve, përfituesve dhe shumat e aprovuara si dhe disa indikatorë të tjerë si sipërfaqet e reja të ngritura, numrin e vendeve të punës si dhe indikatorë të tjerë lidhur me investime specifike).

Kapitulli 5: Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi, bëhet një ndërlidhje e të gjitha të dhënave në kapitujt paraprak për të pasqyruar furnizimin me kultura perimtare, duke përfshirë prodhimin vendor, importin dhe eksportin për të pasqyruar shkallën e plotësimit të nevojave për konsum me prodhim vendor si dhe konsumin për kokë banori.

¹ Të dhënat për sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e kulturave perimtare, të dhënat për numrin e popullsisë, si dhe të dhënat për tregtinë e jashtme që burim primar është Dogana e Kosovës.

² DAESB siguron të dhënat e çmimeve përmes angazhimit të një OE, i cili bën mbledhjen e këtyre të dhënave.

³ Të dhënat për pagesa direkte dhe grante.

Përmbledhje

Sipërfaqja e mbjellë me perime në Kosovë gjatë vitit 2023, përfshinë hapësirën prej 19,602 ha nga të cilat janë prodhuar gjithsej 287,819 tonë perime. Kjo sipërfaqe gjatë periudhës 2021-2023, vazhdimisht shënoi rritje, ndërsa tek prodhimi, kishte ngritje dhe ulje si rezultat i ndryshimeve të rendimentit tek shumica kulturave perimtare.

Janë dhjetë kultura perimtare, si: patatja, speci, fasulja, kungulli, qepa, shalqiri, lakra, kungulli i misirit, domatja dhe trangulli, që përbëjnë 93% të gjithsej sipërfaqes së mbjellë me perime, dhe 95% të gjithsej prodhimit vendor të perimeve. Për përmbushjen e nevojave vendore për konsum, Kosova vazhdon të ketë vlera të larta të importit dhe vlera të ulëta të eksportit, duke pasur një bilanc tregtar negativ në periudhën 2021-2023, por në vitin 2023 me vlerën më të thellë, në krahasim me vitet 2021 dhe 2022.

Prej totalit të përgjithshëm të importit të perimeve në vitin 2023, kulturat të cilat u importuan më së shumti, 89% e gjithsej importit, janë: domatja, speci, shalqiri, fasulja, patatja, qepa, trangulli, fara për mbjellje dhe lakra, që mund të konsiderohen edhe si kulturat më të kultivuara në Kosovë. Kurse 95% e totalit të përgjithshëm të eksportit në vitin 2023, përbëhet nga kulturat perimtare, si: kërpudha, speci, patatja, domatja dhe qepa.

Importi i kulturave perimtare realizohet pothuajse gjatë gjithë vitit, megjithatë, në disa periudha të caktuara vjetore vërehet një ulje e sasisë së importit, por nuk ka ndërprerje të tij. Ndërkaq, eksporti i kulturave perimtare kryhet kryesisht gjatë periudhës së vjeljes, pasi që vendi ynë ka kapacitete të kufizuara për ruajtjen e prodhimit, ndaj ai duhet të shitet ose eksportohet menjëherë pas vjeljes.

Në vitin 2023, kemi rritje të përgjithshme të çmimeve në Kosovë e kjo është reflektuar edhe tek çmimet e disa prej kulturave perimtare. Rritje të çmimeve të disa kulturave kishte tek çmimet e fermës, e që u vazhdua edhe në nivelet e tjera, si në atë me shumicë dhe me pakicë.

Mbështetja financiare qeveritare për sektorin e perimeve në kuadër të PPD 2023 u rrit, duke u bazuar nga mënyra e kultivimit të tyre, si: për perimet e kultivuara në fushë të hapur vlera e mbështetjes financiare u rrit për 38.5%, në vitin 2023, në raport me vitin 2021, për perimet e kultivuara në serra vlera e mbështetjes financiare u rrit për 80.8%, në vitin 2023, në krahasim me vitin 2021, dhe për perimet e kultivuara në mënyrë organike vlera e mbështetjes financiare u rrit për 45.3%, duke subvencionuar gjithsej 3,531 fermerë përfitues të sektorit të perimeve në fushë të hapur dhe 539 fermerë që kultivonin perime në serra në vlerë totale prej rreth 3.2 mil. € apo rreth 5% të vlerës së përgjithshme të pagesave të realizuara në kuadër të PPD-së 2023.

E tërë mbështetja financiare në investim për sektorin e perimeve kishte ndikuar që shkalla e vetëmjaftueshmërisë të jetë relativisht e mirë me një mesatare prej 78% në përmbushjen e nevojave të popullsisë për konsum me kulturat perimtare në periudhën 2021-2023.

1 Prodhimtaria e sektorit të perimeve

Sektori i perimeve në Kosovë përbën një pjesë të rëndësishme të prodhimit bimore me vlerë të konsiderueshme ekonomike. Në prodhimin e përgjithshëm të perimeve janë të përfshira kultivimi i perimeve qoftë në fushë të hapur apo në mjedise të mbrojtura.

1.1 Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i perimeve

Në vitin 2023, sipërfaqja e mbjellë me perime në Kosovë ishte 19,602 ha, që në krahasim me vitin paraprak shënon një rritje për 0.2% të sipërfaqes së mbjell me perime.

Tabela 1: Sipërfaqja e kulturave perimtare 2021-2023, në ha

Kultura	2021	2022	2023	Pjesëmarrja në % (2023)	Ndryshimi 2023/2022 në %
Patate	3,854	3,884	3,918	20.0	0.9
Spec	3,146	3,154	3,178	16.2	0.8
Fasule	2,914	2,941	2,956	15.1	0.5
Kungull	2,612	2,628	2,621	13.4	-0.3
Qepë	1,369	1,376	1,392	7.1	1.1
Shalqi	1,309	1,316	1,307	6.7	-0.7
Lakër	923	937	946	4.8	0.9
Kungull misiri	918	926	853	4.4	-7.9
Domate	800	805	793	4.0	-1.5
Trangull	305	315	307	1.6	-2.5
Pjepër	321	329	312	1.6	-5.1
Hudhër	263	270	274	1.4	1.2
Spinaq	154	162	174	0.9	6.9
Karota	129	132	140	0.7	5.9
Sallatë	82	84	89	0.5	5.8
Presh (purri)	78	80	89	0.5	11.3
Bizele	69	68	71	0.4	5.5
Lulelakër	52	57	62	0.3	9.7
Bishtajoret tjera	46	44	51	0.3	16.9
Patëllxhan i zi	8	9	14	0.1	55.8
Majdanoz	12	14	14	0.0	-4.1
Panxhar i kuq	7	9	10	0.1	9.2
Rrepkë (rilkë)	5	4	6	0.0	26.6
Perime tjera	23	26	28	0.1	10.6
Gjithsej sipërfaqja me perime	19,399	19,571	19,602	100.0	0.2

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23)

Sipas të dhënave të cilat janë prezantuar në tabelën e mësipërme, kulturat që në vitin 2023, kanë shënuar ulje mbi 4% në sipërfaqen e kultivuar në raport me vitin 2022, kanë qenë: kungulli misiri, pjepri, majdanozi, ndërsa tek kulturat që tregojnë rritje të sipërfaqeve të mbjella, rritja me e theksuar ishte tek patëllgjani i zi, rrepka dhe bishtajoret tjera.

Sa i përket pjesëmarrjes së kulturave në gjithsej sipërfaqen e mbjellë me perime, 93.2% e kësaj sipërfaqeje është e mbjellë me: patate, spec, fasule, kungull, qepë, shalqi, lakër, kungull misiri, domate dhe trangull, ndërsa në pjesën tjetër prej 6.8% kultivohen me kultura të tjera perimtare.

Nga 19,602 ha, të mbjellë gjatë vitit 2023, janë prodhuar gjithsej 287,819 tonë me perime dhe shikuar në përgjithësi, gjatë vitit 2023, ka zvogëlim të prodhimit të perimeve për 2.7% në krahasim me vitin 2022. Kjo rënie e prodhimit ka ardhur si rezultat i uljes së rendimentit tek të gjitha kulturat perimtare, përkundër asaj se ka pasur rritje të sipërfaqes së mbjellë tek shumica prej kulturave.

Tabela 2: Prodhimi i kulturave perimtare 2021-2023, në tonë

<i>Kultura</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>	<i>Pjesëmarrja në % (2023)</i>	<i>Ndryshimi 2023/2022 në %</i>
<i>Patate</i>	73,984	75,500	75,639	26.3	0.2
<i>Spec</i>	52,381	55,353	53,751	18.7	-2.9
<i>Fasule</i>	5,349	5,597	5,176	1.8	-7.5
<i>Kungull</i>	22,326	22,551	21,826	7.6	-3.2
<i>Qepë</i>	17,792	19,190	19,012	6.6	-0.9
<i>Shalqi</i>	25,971	27,490	25,623	8.9	-6.8
<i>Lakër</i>	24,123	25,546	25,498	8.9	-0.2
<i>Kungull misiri</i>	20,896	21,975	19,815	6.9	-9.8
<i>Domate</i>	19,163	20,206	19,695	6.8	-2.5
<i>Trangull</i>	8,480	8,973	8,652	3.0	-3.6
<i>Pjepër</i>	4,103	4,467	4,027	1.4	-9.8
<i>Hudhër</i>	1,471	1,594	1,463	0.5	-8.2
<i>Spinaq</i>	1,408	1,557	1,560	0.5	0.3
<i>Karota</i>	1,585	1,770	1,810	0.6	2.2
<i>Sallatë</i>	635	708	701	0.2	-1.0
<i>Presh (purri)</i>	1,398	1,465	1,585	0.6	8.2
<i>Bizele</i>	138	154	146	0.1	-4.9
<i>Lulelakër</i>	885	954	1013	0.4	6.2
<i>Bishtajoret tjera</i>	116	116	133	0.0	14.9
<i>Patëllxhan i zi</i>	144	174	246	0.1	40.3
<i>Majdanos</i>	130	151	136	0.0	-10.0
<i>Panxhar i kuq</i>	51	67	66	0.0	-2.5
<i>Rrepkë (rilkë)</i>	45	50	55	0.0	10.7
<i>Perime tjera</i>	162	194	190	0.1	-1.9
<i>Gjithsej prodhimi i perimeve</i>	282,734	295,802	287,819	100.0	-2.7

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23)

Në tabelën më sipër, është prezantuar prodhimi i kulturave perimtare, ku lehtësisht vërehet se është shënuar ulje e prodhimit në raport me vitin 2022 për 2.7%. Numri i kulturave që kanë shënuar rënie është më i madh sesa i atyre që kanë shënuar rritje. Rritje të prodhimit prej më shumë se 10% në raport me vitin 2022, ka shënuar patëllgjani i zi (40.3%) rrepka 10.7% dhe bishtajoret tjera (14.9%), ndërsa rritja tek kulturat e tjera ka variuar nga 0.2% deri në 9.8%.

Kushtet klimatike që kanë qenë prezente në Kosovë, gjatë vitit 2023, kanë qenë shkaktari kryesor në uljen e rendimentit të kulturave perimtare, ku ulja në rendiment ka variuar nga 0.7% tek patatja deri në 12.6% tek rrepka.

Tabela 3: Rendimenti i kulturave perimtare 2021-2023, në tonë/ha

<i>Kultura</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>	<i>Ndryshimi 2023/2022 në %</i>
<i>Patate</i>	19.20	19.44	19.31	-0.7
<i>Spec</i>	16.65	17.55	16.92	-3.6
<i>Fasule</i>	1.84	1.90	1.75	-8.0
<i>Kungull</i>	8.55	8.58	8.33	-2.9
<i>Qepë</i>	13.00	13.94	13.66	-2.0
<i>Shalqi</i>	19.84	20.89	19.60	-6.2
<i>Lakër</i>	26.13	27.26	26.95	-1.1
<i>Kungull misiri</i>	22.76	23.72	23.22	-2.1
<i>Domate</i>	23.95	25.10	24.85	-1.0
<i>Trangull</i>	27.82	28.50	28.19	-1.1
<i>Pjepër</i>	12.80	13.59	12.91	-5.0
<i>Hudhër</i>	5.59	5.90	5.35	-9.3
<i>Spinaq</i>	9.15	9.58	8.99	-6.2
<i>Karota</i>	12.28	13.38	12.92	-3.5
<i>Sallatë</i>	7.76	8.43	7.89	-6.4
<i>Presh (purri)</i>	17.97	18.38	17.85	-2.8
<i>Bizele</i>	1.99	2.27	2.05	-9.8
<i>Lulelakër</i>	16.96	16.79	16.26	-3.1
<i>Bishtajoret tjera</i>	2.53	2.66	2.61	-1.7
<i>Patëllxhan i zi</i>	17.34	19.62	17.67	-9.9
<i>Majdanoz</i>	10.63	10.69	10.04	-6.1
<i>Panxhar i kuq</i>	7.13	7.72	6.89	-10.7
<i>Rrepkë (rilkë)</i>	9.11	11.31	9.89	-12.6
<i>Perime tjera</i>	6.98	7.53	6.68	-11.2

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23)


Prej kulturave që kanë shënuar uljen më të madhe të rendimentit në raport me vitin 2022, janë: rrepka 12.6%, perimet tjera 11.2%, panxhari i kuq 10.7% dhe të gjitha kulturat e tjera kishin rënie nën 10%.

1.2 Kulturat perimtare më të kultivuara

Renditja sipas sipërfaqes në kultivimin e kulturave perimtare në përgjithësi nuk ka ndryshim përgjatë tri viteve të fundit.

Mesatarja e pjesëmarrjes së kulturave sipas sipërfaqes së kultivuar është, si vijon: patate (20%), spec (16%), fasule (15%), kungull (13%), qepë (7%), shalqi (7%), lakër (5%), kungull misiri (4%), domate (4%), trangull (2%) dhe perime të tjera (7%).

Figura 1: Renditja e kulturave perimtare sipas sipërfaqes së kultivuar për tri vitet e fundit




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.2.1 Patate

Kultivimi i patates dominon për nga sipërfaqja e kultivuar me perime në vitin 2023. Sipërfaqja e mbjellë me patate ishte 3,918 ha apo 0.9% më e lartë sesa në vitin 2022, ndërsa prodhimi shënoi ngritje për 0.2% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, përkundër se rendimenti në vitin 2023, pësoi një rënie prej 0.7%.

Rendimenti mesatar i patates në periudhën 2021-2023, ishte 19.3 tonë për hektar dhe sipërfaqja e kultivuar me patate u rrit në përqindje afërsisht të njëjta sikurse në vitin paraprak (0.8% në vitin 2022 dhe 0.9% në vitin 2023).

Figura 2: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i patates




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.2.2 Spec

Gjatë vitit 2023, sipërfaqja e kultivuar me spec ishte 3,178 ha apo 0.8% më e lartë sesa në vitin 2022, prodhimi ka shënuar rënie për 3% si rezultat i rënies së rendimentit për 4%.

Rendimenti mesatar për kulturën e specit në periudhën 2021-2023 ishte 17.04 tonë për hektar, duke rezultuar me prodhimtari mesatare prej 53,828 tonë.

Figura 3: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i specit




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.2.3 Fasule

Zgjerimi i sipërfaqes së mbjellë me fasule, në vitin 2023, është për 15 ha më shumë sesa në vitin 2022 ose 0.5%. Gjithsej sipërfaqe e mbjellë me fasule gjatë vitit 2023 ishte 2,956 ha, mirëpo prodhimi i kësaj kulture ka shënuar rënie për 8% duke qenë se edhe rendimenti në vitin 2023 ka pësuar rënie 8%. Mesatarja e rendimentit për fasulen në periudhën 2021-2023, ishte 1.83 tonë për hektar dhe ka rezultuar me gjithsej prodhimtari mesatare prej 5,374 tonë.

Figura 4: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i fasules




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.2.4 Kungull

Sipërfaqja mesatare e mbjellë me kungull në periudhën 2021-2023, ishte 2,620 ha, përderisa mesatarja e rendimentit për periudhë 2021-2023, ishte 8.5 tonë për hektar, ndërsa mesatarja e

prodhimit ishte 22,234 tonë, duke shënuar kështu një rënie prej 3% të prodhimit në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.

Figura 5: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kungullit




Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

1.2.5 Qepë

Sipërfaqja e kultivuar me qepë kishte pjesëmarrje të njëjtë të përqindjes ndër vite (prej 7.1%). Në vitin 2023, sipërfaqja e mbjellë ishte 1,392 ha (16 ha më shumë sesa në vitin paraprak), por ka një rënie të prodhimit të kulturës së qepës.

Rendimenti i kësaj kulture ka shënuar rënie për 2% në vitin 2023, në raport me vitin 2022, ndërsa prodhimi mesatar i kulturës së qepës për periudhën 2021-2023, ishte 18,665 tonë, kishte rënie tek prodhimi për 1% në vitin 2023, në raport me vitin 2022.

Figura 6: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i qepës




Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

1.2.6 Shalqi

Sipërfaqja e kultivuar me shalqi gjatë viti 2023, ishte 1,307 ha, që ndryshon për 9 ha më pak sesa në vitin 2022, apo shprehur në përqindje 0.7%. Prodhimi shënoi rënie për 6.8%, si rezultat i uljes së rendimentit për 6.2%.

Figura 7: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i shalqirit




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.2.7 Lakër

Në vitin 2023, sipërfaqja e mbjellë me kulturën e lakrës ishte 946 ha dhe shënon rritje për 0.9% në krahasim me vitin 2022. Pavarësisht rritjes së sipërfaqes së mbjellë, kjo kulturë ka shënuar rënie të prodhimtarisë për 0.2%, si rezultat i rënies së rendimentit për 1.1%.

Figura 8: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i lakrës




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.2.8 Kungull misiri

Sipërfaqja e mbjellë me kungull misiri gjatë vitit 2023, ishte 853 ha apo 7.9% më pak se në vitin 2022, ndërsa prodhimtaria e kësaj kulture ka shënuar rënie për 9.8%, si rezultat i rënies së rendimentit për 2.1%

Figura 9: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kungullit të misirit




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.2.9 Domate

Sipërfaqja e mbjellë me domate gjatë vitit 2023, ishte 793 ha ku shënon rënie për 12 ha ose 1.5%, sikurse gjithsej prodhimi i kësaj kulture që gjithashtu shënoi rënie për 2.5%, si rezultat i zvogëlimit të sipërfaqes së mbjellë por edhe i rënies së rendimentit për 1.0%.

Me 7 hektar më shumë në vitin 2021, sesa në vitin 2023, kultura e domates ka dhënë rendiment më të ulët për 0.8 tonë për hektar si rezultat i kushteve jo të favorshme klimatike në krahasim me situatën gjatë vitit 2022 dhe 2023.

Figura 10: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i domates




Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.2.10 Tranggull

Kultura e tranggullit është kultura e fundit, nga dhjetë kulturat më të kultivuara të perimeve gjatë vitit 2023 në Kosovë. Sipërfaqja e mbjellë me këtë kulturë gjatë vitit 2023, ishte 307 ha dhe shënoi rënie për 2.5%, në krahasim me sipërfaqen e mbjellë në vitin paraprak. Si rezultat i rënies së sipërfaqes së mbjellë dhe rënies së rendimentit për 1.1%, prodhimi shënoi rënie për 3.6%.

Figura 11: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i tranggullit



Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2 Tregtia për sektorin e perimeve

Tregtia është një proces i shkëmbimit të mallrave, shërbimeve ose të drejtave midis individëve, bizneseve ose vendeve. Tregtia është një nga shtyllat kryesore të ekonomisë dhe ndihmon në zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Për qëllim ka furnizimin e popullsisë dhe prezantohet përmes eksportit dhe importit të këtyre prodhimeve. Për dallim nga eksporti që nënkupton daljen e mallrave nga një vend, importi nënkupton mallin që hyn nga një vend tjetër.

Të dhënat e eksportit dhe importit në Kosovë, për kodin doganor dyshifror 07 (Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve), janë prezantuar në tabelën 4, ku është dhënë një pasqyrë e përgjithshme e të dhënave për këtë kod.

Të dhënat e tabelës më poshtë, tregojnë se vlera e eksportit në € për vitin 2023 ka shënuar ngritje për 16.4%, përderisa vlera e importit për të njëjtin vit ka shënuar rritje për 48.3%.


Tabela 4: Eksporti dhe importi për perime (kodin doganor 07⁴)

		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	6,415	9,817	11,423
	Sasia në tonë	10,524	13,227	14,597
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	31,150	33,906	50,282
	Sasia në tonë	76,023	69,360	71,861
Burimi:		ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR		

Sipas të dhënave të përpunuara, sasia e eksportit për vitin 2022, në kodin doganor 07 ka shënuar rritje prej 26%, në krahasim me vitin 2021, ndërsa importi për të njëjtën periudhë ka shënuar rënie prej 9%, ndërkaq në vitin 2023, për të njëjtin kod, sasia e eksportit ka shënuar ngritje për 10%, përderisa sasia e importuar për të njëjtin kod ka shënuar rritje për 4%, për të njëjtën periudhë.

⁴ Në kodin doganor 07 janë të përfshira të gjitha perimet me përjashtim të shalqirit dhe pjeprit të cilat hyjnë në kuadër të kodit doganor 08 (pemët).

Figura 12: Pjesëmarrja e vlerës së importit dhe eksportit të perimeve (kodi doganor 07), në vlerën e importit dhe eksportit të produkteve bujqësore (kodet doganore 01-24)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Pjesëmarrja e vlerës së përgjithshme të eksportit të kodit doganor 07 (perimet), në gjithsej eksportin e kodeve doganore bujqësore (01-24), është 8% në vitin 2023, që nënkupton se nuk ka rënie të përqindjes së pjesëmarrjes në raport me vitin paraprak, ndërsa pjesëmarrja e vlerës së përgjithshme të importit të kodit 07 (perimet), për periudhën 2021-2022 është 3%, ndërsa në vitin 2023 ka pjesëmarrje 4%.

Bilanci tregtar për kodin doganor 07, në vitin 2023, vazhdon të ketë vlerë negative rreth 39 mil. €, duke shënuar kështu edhe vlerën më të thellë në tre vitet e fundit.

Figura 13: Eksporti, importi dhe bilanci tregtar për perime (kodi doganor 07⁵), në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Si vërehet edhe në figurën më lartë, vlera e importit të kodit doganor 07, është më e madhe sesa vlera e produkteve të eksportuara, që kështu reflekton një bilanc tregtar negativ përgjatë tri viteve të fundit.

⁵ Në kodin doganor 07 nuk janë përfshirë shalqiri dhe pjepri.

2.1 Eksporti dhe importi i kulturave perimtare

Kulturat perimtare më të eksportuara për tre vitet e fundit (2021-2023), sipas vlerës në € dhe sasisë së kulturave të eksportuara për njësinë – kilogram, janë prezantuar në tabelën në vazhdim dhe radhitja e tyre është bërë sipas vlerës së eksportuar në € gjatë vitit 2023.

Në vitin 2023, vlera e përgjithshme e eksportit të kulturave perimtare ishte 11.4 mil. €, që është 1.6 mil. € më shumë sesa në vitin 2022.

Kulturat perimtare më të eksportuara gjatë vitit 2023, ishin: kërpudha, speci, patatja, domatja dhe qepa. Këto kultura paraqesin 95% të vlerës së përgjithshme të eksportit, pasuar nga kulturat e tjera të paraqitura si në tabelën 5, pjesëmarrja e përgjithshme e të cilave është 5%.

Pesë kulturat më të eksportuar që kishin pjesëmarrje prej 95%, në gjithsej vlerën e eksportit në vitin 2023, gjatë vitit 2022 kishin pjesëmarrje 88% dhe 79% në vitin 2021.


Tabela 5: Eksporti i kulturave perimtare

Kultura	2021		2022		2023	
	Vlera në €	Sasia në kg	Vlera në €	Sasia në kg	Vlera në €	Sasia në kg
Kërpudha	2,696,727	354,529	5,764,562	849,625	6,203,555	1,298,842
Speci	1,647,099	2,351,836	1,652,405	2,128,369	2,330,578	1,808,297
Patate	634,205	4,498,704	899,905	5,816,146	1,439,193	8,479,081
Domate	72,821	137,231	215,155	501,118	603,065	1,055,342
Qepa	14,908	12,414	99,873	485,042	227,124	655,821
Tranguilli	589,854	965,097	379,675	694,243	218,206	383,742
Lakër	388,444	1,765,289	499,067	2,450,062	111,426	498,018
Fasule	40,232	19,263	26,974	12,338	94,852	88,289
Kungull dhe kungull misiri	66,013	157,221	73,133	174,982	55,410	129,297
Karota dhe rrepa	40,631	137,351	14,273	38,272	54,756	145,726
Shalqi	4,003	9,428	12,844	78,910	5,863	11,160
Kungulleshka	6,802	23,545	3,472	27,062	4,338	8,160
Lulelakra dhe Brokoli	5,653	4,200	164	647	779	1,130
Hudhër	1,940	682	520	346	572	155
Pjepër	19,182	11,005	3,641	8,680	191	80
Sallata	28,003	11,128	5,407	3,991	188	78
Fara për mbjellje	76,575	63,500	10,065	7,500	-	-
Patëllxhan	1,315	1,286	583	753	-	-
Spinaq	1,063	3,317	-	-	-	-
Misër i ëmbël	960	1,065	1,056	1,191	-	-
Asparagu	740	37	55	5	-	-
Panxhar	229	230	-	-	-	-
Presh	126	103	-	-	-	-
Perime të tjera	100,657	15,794	170,481	34,896	78,912	45,360

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në figurën 14 është prezantuar pjesëmarrja e kulturave perimtare më të eksportuara për tre vitet e fundit (2021-2023).

Figura 14: Vlera e eksportit të kulturave perimtare, në %



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Mesatarja e kulturave më të eksportuara në tre vitet e fundit, është si vijon: kërpudha 52%, speci 21%, patatja 11%, domatja 3% dhe qepa 1%, ndërsa pjesëmarrja mesatare e perimeve të tjera (të cilat nuk janë paraqitur në figurën 14), është 13%.

Sikurse eksporti edhe importi i kulturave perimtare është prezantuar njëjtë në formë tabelare: vlera e përgjithshme e importit të kulturave perimtare në vitin 2023 ishte 56.5 mil. € apo 18.9 mil. € më shumë sesa në vitin 2022.

Tabela 6: Importi i kulturave perimtare

Kultura	2021		2022		2023	
	Vlera në €	Sasia në kg	Vlera në €	Sasia në kg	Vlera në €	Sasia në kg
<i>Domate</i>	6,459,176	18,685,791	6,818,819	13,181,588	11,954,832	16,586,327
<i>Speci</i>	5,162,971	12,168,422	5,895,532	10,750,986	11,511,972	13,638,370
<i>Shalqi</i>	3,790,250	25,363,862	3,352,285	18,175,040	5,750,135	17,581,223
<i>Fasule</i>	4,060,696	4,477,363	4,179,896	4,403,709	4,698,588	4,670,960
<i>Patate</i>	2,473,924	10,608,484	3,200,545	10,649,906	4,560,944	10,160,529
<i>Qepa</i>	2,644,760	9,477,463	2,304,191	8,220,321	4,036,466	6,563,228
<i>Trangulli</i>	2,145,341	5,711,107	2,571,764	5,870,347	3,046,310	5,414,240
<i>Fara për mbjellje</i>	2,160,197	3,087,923	2,280,227	3,137,270	2,951,455	3,587,781
<i>Lakër</i>	1,353,575	5,989,480	1,782,015	7,451,085	1,641,131	5,250,192
<i>Pjepër</i>	402,277	992,244	361,629	768,729	503,719	699,409
<i>Karota dhe rrepa</i>	195,784	414,514	204,448	337,866	394,982	663,305
<i>Kërpudha</i>	440,765	239,878	317,487	179,038	384,181	178,705
<i>Sallata</i>	378,807	335,897	296,583	275,732	377,608	310,797
<i>Patëllxhan</i>	197,822	334,433	226,575	301,239	347,657	339,698
<i>Kungulleshka</i>	194,247	366,948	250,383	522,389	340,893	458,515
<i>Lulelakra dhe Brokoli</i>	156,705	181,978	166,511	204,401	250,290	211,446
<i>Presh</i>	156,987	345,827	147,971	383,138	176,959	394,121
<i>Kungull dhe kungull misiri</i>	108,860	193,752	113,651	204,954	129,683	192,086
<i>Misër i ëmbël</i>	87,554	140,736	105,723	112,917	98,636	118,140
<i>Spinaq</i>	94,272	112,039	86,048	77,956	87,198	67,156
<i>Hudhër</i>	94,791	81,518	105,987	88,734	83,358	54,034
<i>Panxhar</i>	40,987	90,468	31,679	57,459	62,629	73,613
<i>Asparagu</i>	8,495	2,026	6,384	1,312	7,594	1,262
<i>Perime të tjera</i>	2,533,520	2,976,616	2,813,247	2,947,910	3,139,096	2,926,157


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Kulturat perimtare më të importuara gjatë vitit 2023 ishin: domatja, speci, shalqiri, fasulja, patatja, qepa, trangulli, fara për mbjellje dhe lakra. Këto kultura paraqesin 89% të vlerës së përgjithshme të importit, pasuar nga kulturat e tjera, pjesëmarrja e përgjithshme e të cilave është 11%.

Pjesëmarrja e kulturave më të importuara në tre vitet e fundit ishte afërsisht e njëjtë. Në vitin 2021 dhe 2022, pjesëmarrja ishte prej 86%, ndërsaq në vitin 2023 ishte 3 pikë % më e lartë, përkatësisht 89%.

Në figurën 15 janë paraqitur kulturat perimtare të cilat edhe pse prodhohen në Kosovë, vazhdojnë të jenë edhe kulturat më të importuara në vend kryesisht jashtë sezonës së vjeljes dhe për shkak të kapaciteteve të kufizuara për ruajtje të produktit final.

Figura 15: Vlera e importit të kulturave perimtare, në %



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Mesatarja e kulturave më të importuara në tri vitet e fundit është si vijon: domate 19%, spec 17%, shalqi 10%, fasule 10%, patate 8%, qepë 7%, trangull 6%, fara për mbjellje 6, lakër 4% ndërkaj pjesëmarrja mesatare e perimeve të tjera (të cilat nuk janë paraqitur në figurën 15), është 13%.

2.1.1 Eksporti dhe importi i patates

Kultivim i patates është në epërsi për sa i përket sipërfaqes së mbjellë në Kosovë në krahasim me perimet e tjera, mirëpo nga të dhënat e tregtisë llogaritet si kultura e tretë e cila eksportohet më së shumti dhe e pesta e cila importohet.

Të dhënat e eksportit dhe importit të patates për periudhën 2021-2023, tregojnë se bilanci tregtar në vitin 2023, është pozitiv në vlerë prej 3.1 mil. € po ashtu edhe në viti 2022, kur vlera e këtij bilanci ishte pozitiv për 2.3 mil €. Sasia e eksportuar e patates në vitin 2023, ishte dukshëm më e lartë sesa sasia e eksportuar në vitin 2022.

Tabela 7: Eksporti dhe importi i patates


		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	634	900	1,439
	Sasia në tonë	4,499	5,816	8,479
	Vlera për njësi të patates së freskët të eksportuar (€/kg)	0.14	0.15	0.17
	Vlera për njësi të patates jo të freskët të eksportuar (€/kg)	-	1.13	3.70
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	2,474	3,201	4,561
	Sasia në tonë	10,608	10,650	10,161
	Vlera për njësi të patates së freskët të importuar (€/kg)	0.23	0.30	0.45
	Vlera për njësi të patates jo të freskët të importit (€/kg)	2.08	1.10	2.77

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Mesatarja e vlerës për njësi e patates së freskët të eksportuar është 0.16 €/kg, ndërsa e asaj të importuar është 0.33 €/kg, përderisa mesatarja e vlerës për njësi e patates jo të freskët të eksportuar është 2.42 €/kg, ndërsa e asaj të importuar është 1.98 €/kg, ndërsa çmimi në vitin 2023, për patate jo të freskët të eksportuar është 3.70 €/kg për shkak se ka eksport të patateve të thara e që nuk ka pasur në vitin 2022.

Eksporti i patates

Në bazë të të dhënave, sasia e patates së eksportuar në vitin 2023, është 46% më shumë sesa në vitin 2022. Në figurën 16, prezantohet eksporti i patates për periudhën 2021–2023, sipas vlerës në € dhe sasisë në tonë, ku në vitin 2023 janë eksportuar 539 mijë. € më shumë apo rreth 2,663 tonë sasi patate më shumë se në vitin 2022. Nga kjo del se sasia e eksportit të kulturës së patates ka rritje për 45.8% në vitin 2023, në raport me vitin 2022.


Figura 16: Eksporti i patates 2021-2023

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Të dhënat e eksportit sipas muajve për periudhën 2021–2023, tregojnë se sasia më e madhe e eksportuar në vitin 2023, ka qenë gjatë muajit shkurt me 1,558 tonë, ndërsa në vitin 2022, sasia më e madhe e eksportuar ka qenë në muajin mars me 1,058 tonë dhe në vitin 2021 në muajin janar me 968 tonë.

Në periudhën 2022-2023 eksport të patates kishte gjatë gjithë vitit për dallim nga viti 2021 ku në muajin qershor nuk kishte fare eksport. Sasi më e vogël e patates është eksportuar në muaj maj dhe qershor ndërsa sasia më e madhe e eksportuar është në periudhën dhjetor-mars. Sa i përket gjithsej vlerës së eksportit të patates në vitin 2023 vlera më e lartë u arrit në muajin shkurt.

Figura 17: Eksporti i patates sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në përgjithësi, eksporti i patates fillon të jetë më i madh në kohën e viljes së saj dhe vazhdon deri në muajin mars, periudhë kjo ku shënohet sasia më e madhe e patates së eksportuar.

Shtetet në të cilat është realizuar eksporti i patates në vitin 2023 janë: Shqipëria (73%), Bosnja dhe Hercegovina (10%), Maqedonia e Veriut (10) dhe Mali i Zi (7%).

Figura 18: Eksporti i patates sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Edhe në vitin 2022, vendet ku është eksportuar më së shumti kultura e patates ishin të njëjta, por që ndryshim paraqet përqindja e pjesëmarrjes së këtyre shteteve, kështu në Shqipëri (82%), Mal të Zi (10%) dhe Maqedoni e Veriut (8%).

Importi i patates

Sipas të dhënave të regjistruara nga importi i kulturës së patates, shihet se është rritur importi mbi 43% (në vlerë) në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, dhe kjo rritje është si rezultat i rritjes së çmimit përkundër asaj se sasia e importuar ka shënuar rënie.


Figura 19: Importi i patates 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Të dhënat për periudhën 2021–2023, tregojnë qartë rritje të importit për nga vlera në € por jo edhe nga sasia e importuar. Sipas këtyre të dhënave del se në vitin 2023, janë importuar 1.3 mil. € më shumë sesa në vitin 2022, apo 489 tonë më pak sasi e importuar në vitin 2023, sesa në vitin 2022.

Figura 20: Importi i patates sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sipas të dhënave të importit të patates sipas muajve për periudhën 2021–2023, shihet se: në vitin 2023, në muajin qershor është regjistruar sasia më e madhe e importit me 1,721 tonë, për vlerën 851 mijë €, ndërkah në muajin shtator është regjistruar sasia më e vogël e importuar me 39 tonë, për vlerën 24 mijë €, e njëjta nuk mund të thuhet edhe për vitet paraprake 2021 dhe 2022, pasi sasia më e madhe e importit është regjistruar në muajin qershor me 1,902 tonë, për vlerën 380 mijë € në vitin 2021, dhe në muajin maj me 1,594 tonë për shumën 450 mijë € në vitin 2022, ndërkah sasia më e vogël e importit është regjistruar në muajin gusht (për të dyja vitet e analizës), me 113 tonë për vlerën 31 mijë €, në vitin 2021 dhe me 324 tonë për vlerën 78 mijë €, në vitin 2022.

Shtetet prej nga është realizuar sasia më e madhe e importit kanë shtrirje edhe përtej vendeve të rajonit. Importi i patates në vitin 2022, është realizuar nga: Shqipëria (30%), Gjermania (23%), Egjipti (14%), Franca (13%), Mali i Zi (11%), dhe vendet e tjera (9%), ndërsa në vitin 2023, nga Shqipëri janë importuar (17%), e sasisë së përgjithshme të patates, nga Egjipti 49%, nga Gjermania 12%, nga Franca 8%, nga Mali i Zi 4% dhe nga vendet e tjera 10%.

Figura 21: Importi i patates sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2.1.2 Eksporti dhe importi i specit

Kultura e specit është kulturë tradicionale e cila kultivohet si në kopshte po ashtu edhe në sipërfaqe më të mëdha si në fushë të hapur dhe në serra.

Kultura e specit renditet e dyta për nga sipërfaqja e mbjellë në Kosovë, njëjtë sikurse edhe në regjistrin e tregtisë që llogaritet si kultura e dytë e cila eksportohet dhe importohet më së shumti.

Të dhënat e eksportit dhe importit të specit për periudhën 2021-2023, tregojnë se bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ duke e thelluar vlerën edhe për 4.94 mil. € më shumë në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, ku bilanci tregtar ishte negativ me 9.1 mil € në vitin 2023. Sasia e eksportuar e specit në vitin 2023, është më e vogël për 320 tonë në krahasim me vitin 2022, ndërsa është rritur sasia e importuar gjatë vitit 2023 për 2,887 tonë në krahasim me vitin 2022.

Tabela 8: Eksporti dhe importi i specit

		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	1,647	1,652	2,331
	Sasia në tonë	2,352	2,128	1,808
	Vlera për njësi të specit së freskët të eksportuar (€/kg)	0.70	0.77	1.28
	Vlera për njësi të specit jo të freskët të eksportuar (€/kg)	-	1.08	1.73
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	5,163	5,896	11,512
	Sasia në tonë	12,168	10,751	13,638
	Vlera për njësi të specit së freskët të importuar (€/kg)	0.42	0.58	0.84
	Vlera për njësi të specit jo të freskët të importuar (€/kg)	1.65	-	4.06


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Mesatarja e vlerës për njësi e specit të freskët të eksportuar është 0.92 €/kg, ndërkohë mesatarja e vlerës për njësi e specit të freskët të importuar është 0.61 €/kg. Ndërsa vlera për njësi të specit jo të freskët është 1.08 €/kg për vitin 2022, ndërsa në vitin 2023, çmimi për njësi të specit jo të freskët të eksportuar është 1.73 €/kg ku kemi një rritje të çmimit në vitin e fundit.

Eksporti i specit

Eksporti i specit ka shënuar rritje në tre vitet e fundit, kjo rritje është tek vlera, ndërsa tek sasia kemi ulje. Sasia e eksportuar në vitin 2023, ishte 320 tonë më pak se sa në vitin 2022, por për 678 mijë €, më shumë se sa në vitin 2022.

Figura 22: Eksporti i specit 2021-2023




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në periudhën 2021-2023, kemi rritje të vlerës për njësi të eksportuar që ndikon në rritjen e vlerës së përgjithshme të eksportit. Në vitin 2022, vlera për njësi të specit të freskët të eksportuar ishte rritur për 9.9% në krahasim me vitin 2021, ndërsa në vitin 2023, rritja është 66% në krahasim me vitin 2022.

Bazuar në të dhënat sipas muajve për periudhën 2021-2023, rezulton se eksport të specit ka kryesisht në kohën e vjeljes së specit.

Muaji shtator dhe muaji gusht për të tre vitet e analizës, prezanton regjistrime të larta të eksportit të kulturës së specit, përderisa ka muaj të ndryshëm kur nuk është regjistruar fare eksport për këtë kulturë në të tri vitet e fundit.

Figura 23: Eksporti i specit sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Nga shtetet në të cilat është bërë eksporti i specit në vitin 2023, janë: Gjermania me 49%, Suedia me 13%, Zvicra me 12%, Serbia me 10%, Belgjika me 5%, Mbretëria e Bashkuar 2% dhe vendet

e tjera me 9%, ndërsa në vitin 2022, në Gjermani janë eksportuar 45% e sasisë së përgjithshme të specit të eksportuar, në Suedi 16%, në Zvicër 12%, Serbia 9% në Belgjikë 5%, në Austri 4% dhe në vendet e tjera 9%.

Figura 24: Eksporti i specit sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i specit

Nga viti 2022 kur kishte rritje të vlerës së importit të specit për 14%, në krahasim me vitin 2021, rritja vazhdoi edhe në vitin 2023 me 95%, në krahasim me vitin 2022 por që kjo rritje vjen më shumë nga ajo se është rritur çmimi për njësi të importuar ku vlera mesatare për njësi të importit të specit të freskët në vitin 2023 ishte 0.84 €/kg, përderisa mesatarja në periudhën 2021-2022 ishte 0.49 €/kg. Vlera për njësi e specit jo të freskët të importuar në vitin 2021 ishte 1.65 €/kg ndërsa në vitin 2023, ishte 4.06 €/kg, vlera më e lartë për njësi në vitin 2023, rezulton nga importi i specit Pimenta i cili është shumë më i shtrenjtë se sa varietete e tjera të specit dhe në vitin 2023, ishte i vetmi lloj i specit jo të freskët të importuar në krahasim me vitin 2021 kur ka lloje të tjera dhe kishte pjesëmarrje shumë të vogël.


Figura 25: Importi i specit 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i specit është realizuar pa pasur shpërndarje nëpër muaj, gjatë gjithë viteve, ndërsa muajt maj dhe qershor gjatë të tri viteve të analizës (2021-2023), janë muajt kur është importuar më së shumti kultura e specit në Kosovë.

Figura 26: Importi i specit sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Shqipëria është vendi prej nga është vërejtur vlera më e madhe e importit në Kosovë gjatë vitit 2022, me 34% të vlerës së përgjithshme të importit, po ashtu edhe nga Turqia 34%, Greqia 17%, Maqedonia e Veriut 14%, dhe vendet e tjera 1%.

Nga të njëjtat vende është importuar edhe gjatë vitit 2023, vetëm se me përqindje më të ndryshme, kështu që Turqia prin me 33%, Shqipëria me 32%, pastaj renditet Maqedonia e Veriut me 23%, Greqia me 11%, dhe vendet e tjera me 1% të vlerës së përgjithshme të importit.

Figura 27: Importi i specit sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2.1.3 Eksporti dhe importi i fasules

Prej tërë sipërfaqes së mbjellë me perime në Kosovë, 15% janë të mbjella me kulturën e fasules. Kultura e fasules përveç vlerave të larta ushqyese është një nga kulturat kryesore me pjesëmarrjen e saj në ushqimet e tryezës tradicionale. Të dhënat e tregtisë së fasules, tregojnë

një bilanc negativ duke e thelluar vlerën edhe për 451 mijë € më shumë në vitin 2023, sesa në vitin 2022.

Tabela 9: Eksporti dhe importi i fasules

		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	40	27	95
	Sasia në tonë	19	12	88
	Vlera për njësi të fasules së freskët të eksportuar (€/kg)	2.10	2.19	1.07
	Vlera për njësi të fasules jo të freskët të eksportuar (€/kg)	1.10	-	-
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	4,061	4,180	4,699
	Sasia në tonë	4,477	4,404	4,671
	Vlera për njësi të fasules së freskët të importuar (€/kg)	0.91	0.94	1.00
	Vlera për njësi të fasules jo të freskët të importuar (€/kg)	0.95	1.12	1.40


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sasia e eksportuar në vitin 2023, është rritur për (7) herë më shumë në krahasim me vitin 2022, njëjtë siç është rritur edhe sasia e importuar për 6% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022. Nga të dhënat e regjistruara del se mesatarja e vlerës për njësi të fasules së freskët të eksportuar është 1.79 €/kg, në vitin 2023 vlera për njësi të eksportuar ka qenë më e ulët përkatësisht 1.07 €/kg, sepse ka pasur me shumë eksport të fasules në lëvozhgë në krahasim me vitet e tjera, ndërkaq e asaj të importuar është 0.95 €/kg, ndërsa mesatarja e vlerës të eksportit për njësi të fasules jo të freskët është 1.10 për vitin 2021, ndërsa në vitet 2022 dhe 2023, nuk kemi eksportuar fare. Vlera për njësi të fasules jo të freskët të importuar (€/kg është 1.16 €/kg.

Eksporti i fasule

Kultura e fasules ka shfaqur rritje të eksportit në vitin 2023. Në vitin 2022 eksporti i fasules ka pas rënie për 13 mijë €, në krahasim me vitin 2021, ndërsa në vitin 2023, eksporti i kësaj kulture është rritur për 68 mijë € në krahasim me vitin 2022.


Figura 28: Eksporti i fasules 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Nga të dhënat e regjistruara vërehet se vlera për njësi të fasules së freskët të eksportuar është rritur në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021, derisa në vitin 2023 kjo vlerë mbetet më e ulët në krahasim me vitet e tjera. Fasules jo të freskët (të konservuar) të eksportuar kemi vetëm në vitin 2021, ndërsa në vitet 2022 dhe 2023 nuk kemi eksportuar këtë lloj të fasules.


Figura 29: Eksporti i fasules sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksporti i fasules në vitin 2023, ka qenë i shpërndarë në muaj, një rritje ka pasur në muajin nëntor ku është eksportuar sasi dhe vlerë më e madhe, ndërsa në vitet paraprake përveç që kishte shpërndarje nga muaji në muaj, vlerat e eksportit ishin tejet të ulëta. Në muajin nëntor të vitit 2023, është shënuar sasia më e madhe e eksportuar në tri vitet e fundit me 70,100 kg dhe në muajin gusht, është shënuar sasia më e vogël e eksportuar me vetëm 50 kg, po ashtu në tri vitet e fundit kemi muaj kur nuk është regjistruar fare sasi e eksportuar.

Figura 30: Eksporti i fasules sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Kultura e fasules gjatë vitit 2022, është eksportuar më së shumti në Gjermani (77%), pasuar nga Mali i Zi (18%), Suedia (3%), dhe vendet e tjera (2%), por gjatë vitit 2023, ka ndryshime ngase prinë Turqia (61%), Shqipëria (15%), Gjermania (14%), Mali i Zi (6%), dhe vendet e tjera (4%).

Importi i fasules

Sipërfaqja e mbjellë me fasule dhe prodhimi vendor në Kosovë, nuk i ka plotësuar nevojat e konsumit të vendit tonë, andaj në të dhënat e importit evidentohet një rritje e vazhdueshme nëpër vite për kulturën e fasules.

Figura 31: Importi i fasules 2021-2023




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sasia e importuar në vitin 2022, ishte më e ulët për 1.65%, në krahasim me importin e vitit 2021, por rritja kishte vazhduar tek në vitin 2023 për 6.07%, në krahasim me vitin 2022.

Sasia më e madhe është importuar pikërisht në kohën e vjeljes, në tre mujorin e fundit të vitit.

Figura 32: Importi i fasules sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Prej vendeve nga është importuar fasulja më së shumti gjatë vitit 2022, është Kirgistani me 74%, pasuar nga Egjipti me 11%, Argjentina me 8%, Shqipëria me 2%, dhe vendet e tjera me 5%.

Përfshirja e vendeve prej nga është importuar fasulja, nuk ndryshon as në vitin 2023, nga ato të vitit 2022 me përjashtim të Polonisë nga ku është importuar në vitin 2023, dhe nuk ka import nga Shqipëria. Kirgistani është në epërsi në listën e vendeve prej nga janë regjistruar të dhënat më të larta të importit të fasules me 59%, pasuar nga Egjipti me 21%, Polonia me 8%, Argjentina me 6% dhe vendet e tjera me 6%.

Figura 33: Importi i fasule sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2.1.4 Eksporti dhe importi i kungullit dhe kungullit të misirit

Për shkak të klasifikimit të përbashkët në kodin doganor të perimeve, kungulli dhe kungulli i misirit përfshihen në të njëjtin pozicion tarifor, ndaj të dhënat tregtare për këto dy kultura analizohen në mënyrë të përbashkët.

Tabela 10: Eksporti dhe importi i kungullit dhe kungullit të misirit

		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	66	73	55
	Sasia në tonë	157	175	129
	Vlera për njësi të kungullit dhe kungullit të misirit të freskët të eksportuar (€/kg)	0.42	0.42	0.43
	Vlera për njësi të kungullit dhe kungullit të misirit jo të freskët të eksportuar (€/kg)	-	-	-
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	109	114	130
	Sasia në tonë	194	205	192
	Vlera për njësi të kungullit dhe kungullit të misirit të freskët të importuar (€/kg)	0.56	0.55	0.68
	Vlera për njësi të kungullit dhe kungullit të misirit jo të freskët të importuar (€/kg)	-	-	-

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR


Gjatë periudhës 2021-2023, bilanci tregtar për kungull dhe kungull misiri ishte negativ dhe vlera e tij pothuajse u dyfishua në vitin 2023, e kjo si rezultat i asaj se eksporti shënoi rënie si në vlerë po ashtu edhe në sasi dhe njëkohësisht vlera e importit shënoi rritje përkundër zvogëlimit në sasi.

Mesatarja e sasisë së eksportuar është 154 tonë dhe sasisë së importuar është 197 tonë, ndërsa mesatarja e vlerës për njësi të eksportuar është 0.42€/kg, dhe mesatarja e vlerës për njësi të importuar është 0.60 €/kg.

Eksporti i kungullit dhe kungullit të misirit

Eksporti i këtyre dy kulturave në vitet (2021-2022), ka vlerë pothuajse të njëjtë për dallim nga viti 2023, ku eksporti i tyre ishte dukshëm më i ulët.

Figura 34: Eksporti i kungullit dhe kungullit të misirit 2021-2023




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Vlera për njësi të eksportuar ishte 0.42 €/kg në vitet 2021 dhe 2022, ndërsa rritja e kësaj vlere nga viti 2022 në vitin 2023, ishte për 2.5%.

Periudha më e përshtatshme për eksportin e kungullit dhe kungullit të misirit në tri vitet e analizës 2021-2023, ishte periudha pas vjeljes së tij (shtator–nëntor), ndërkaq në pjesën tjetër të vitit, nuk ka pasur pothuajse pak e fare eksport.


Figura 35: Eksporti i kungullit dhe kungullit të misirit sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Shtetet në të cilat është eksportuar kultura e kungullit dhe kungullit të misirit në vitet 2022 dhe 2023 janë pothuajse të njëjta me përjashtim që në vitin 2022 kemi 2% eksport në Luksemburg ndërsa në vitin 2023, 8% e eksportit është realizuar në Austri. Sa i përket shteteve ku janë eksportuar më së shumti këto dy kultura janë: Zvicra dhe Gjermania.

Figura 36: Eksporti i kungullit dhe kungullit të misirit sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i kungullit dhe kungullit të misirit

Për plotësimin e nevojave vendore për konsum në vitin 2023, janë importuar 192 tonë me kungull dhe kungull misiri, në vlerë prej 130 mijë €. Vlera për njësi e këtyre kulturave të importuara në vitin 2023 ishte 0.68 €/kg, apo 21.8% më e lartë sesa në vitin 2022.

Figura 37: Importi i kungullit dhe kungullit të misirit 2021-2023




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i këtyre kulturave nëpër muaj tregon një shtrirje kohore të vazhdueshme të importit të këtyre kulturave, një praktikë kjo në të tri vitet e analizës (2021-2023).

Vërehet se prodhimi vendor nuk i ka përmbushur nevojat për konsum, prandaj edhe importi ka ndodhur gjatë gjithë vitit me përjashtim të muajit korrik dhe gusht që nuk janë importuar pothuajse fare këto kultura.

Figura 38: Importi i kungullit dhe kungullit të misirit sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i kungullit dhe kungullit të misirit në vitin 2022, është realizuar nga Shqipëria me (53%), pasuar nga Turqia me (47%), ndërsa në vitin 2023, vendet prej nga janë importuar janë pothuajse të njëjta me ato nga ku u importua në vitin 2023, por ndryshojnë përqindjet e pjesëmarrjes së tyre.

Në vitin 2023, në masë të madhe u importua nga Turqia (69%), pastaj nga Shqipëria (26%), dhe nga Maqedonia e Veriut (5%).

Figura 39: Importi i kungullit dhe kungullit të misirit sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2.1.5 Eksporti dhe importi i qepës

Kultura e qepës renditet e pesta për nga mbjellja e sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Sa i përket tregtimit të saj ajo regjistrohet si kultura e 5-të në renditje të eksportit dhe e 6-ta në renditje të importit. Në vitin 2023, ashtu si edhe në vitin 2022 ka vazhduar rritja e sasisë së eksportuar. Në vitin 2022, sasia e eksportuar shënoi rritje shumë të madhe në krahasim me vitin 2021 ku nga 12 tonë të eksportuar në vitin 2021 sasia u rrit në 485 tonë në vitin 2022. Në vitin 2023 u regjistrua prapë një ngritje e sasisë së eksportuar për 35.2% në raport me vitin 2022. Kërkesa e tregut për import të kësaj kulture ishte dukshëm më e ulët ku u shënua një ulje për rreth (20.2%) në sasisë e importuar në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.

Tabela 11: Eksporti dhe importi i qepës


		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	15	100	227
	Sasia në tonë	12	485	656
	Vlera për njësi të qepës së freskët të eksportuar (€/kg)	0.63	0.21	0.31
	Vlera për njësi të qepës jo të freskët të eksportuar (€/kg)	1.71	-	1.88
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	2,645	2,304	4,036
	Sasia në tonë	9,477	8,220	6,563
	Vlera për njësi të qepës së freskët të importuar (€/kg)	0.26	0.27	0.57
	Vlera për njësi të qepës jo të freskët të importuar (€/kg)	1.78	0.68	1.44

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksporti i qepës

Eksport të qepës kishte në të tri vitet e analizës (2021-2023), por që vlerat e tij janë shumë rezultate të favorshme. Edhe pse është shënuar rritje e eksportit të kësaj kulture, vlerat për njësi të eksportuar ishin më të ulëta, kështu në vitin 2022, vlera për njësi të eksportuar ishte 0.21 €/kg apo 67.2% më e ulët në krahasim me vitin 2021, ndërsa në vitin 2023, kjo vlerë ishte 0.31 €/kg apo 52.1% më e lartë sesa në vitin 2022.

Figura 40: Eksporti i qepës 2021-2023




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Prej të dhënave të regjistruara vërehet se në vitin 2021 dhe 2023, kishte eksport të qepës jo të freskët dhe se vlera e saj për njësi të eksportuar në vitin 2023 është 1.88 €/kg. Në vitin 2022 nuk kishte fare eksport të qepës jo të freskët.

Edhe pse sasi shumë e vogël e eksportuar, të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2023 është realizuar eksporti i kësaj kulture në shumicën e muajve, për dallim nga dy vitet paraprake kur kishte numër më të madh të muajve që nuk është regjistruar eksport fare.


Figura 41: Eksporti i qepës sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksporti i qepës në vitin 2022, është realizuar në Maqedoninë e Veriut me 46% të vlerës së përgjithshme të eksportit, në Shqipëri me 44%, në Serbi me 6%, Mal të Zi me 3%, Kroaci me 1%, ndërsa në vitin 2023, është eksportuar në Maqedoninë e Veriut 48%, Bosnje dhe Hercegovinë 25%, në Shqipëri 23%, në Serbi 2% dhe Kroaci 2%.

Figura 42: Eksporti i qepës sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i qepës

Sasia mesatare e qepës së importuar në periudhën 2021-2023, ishte 8,087 tonë. Në vitin 2022, kishte rënie të vlerës së importit për 12.9%, në krahasim me vitin 2021, ndërkaj në vitin 2023, kishte rritje të vlerës së importit për 75%, në krahasim me vitin 2022. Vlera mesatare për njësi të qepës së freskët të importuar ishte 0.37 €/kg, ndërsa ajo e qepës së tharë ishte, 1.30 €/kg. Sasia më e madhe e importuar është ajo e qepës së freskët, mesatarisht 7,859 tonë për tri vitet e analizës.


Figura 43: Importi i qepës 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Import të kulturës së qepës kishte gjatë gjithë periudhën përfshirë të tri vitet e analizës. Në muajin prill të vitit 2023, shënohet vlera më e lartë e importit atëherë kur vlera për njësi ishte 0.75 €/kg, ndërsa vlera për njësi më e lartë gjatë vitit ishte regjistruar në muajin gusht (0.92 €/kg), dhe ajo më e ulët ishte regjistruar në muajin shkurt (0.44 €/kg).


Figura 44: Importi i qepës sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Vendet nga është importuar pjesa më e madhe e qepës, në vitin 2022 janë: Serbia (36%), pasuar nga Shqipëria (21%), Holanda (18%), Turqia (8%), Austria (6) dhe vendet e tjera (11%). Për dallim nga viti 2022 në vitin 2023, pjesa më e madhe e importit është realizuar nga Holanda (15%), India (12%), Maqedonia e Veriut (12%), Egjipti (11%), Shqipëria (9%) dhe vendet e tjera (41%).

Figura 45: Importi i qepës sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2.1.6 Eksporti dhe importi i shalqirit

Sipërfaqja e mbjellë me shalqi ishte për 0.7% më e ulët në vitin 2023 ku së bashku me rënien në rendiment ndikuar që të ketë edhe rënie të prodhimit. Bilanci tregtar për këtë kulturë vazhdon të jetë negativ dhe shalqiri renditet si kultura e 3-të më e importuar, e njëjta kulturë konsiderohet nga mesi në rang listën e kulturave më të eksportuara.

Të dhënat e eksportit dhe importit të shalqirit, tregojnë se në periudhën 2021-2023, mesatarisht është eksportuar 8 mijë € apo në sasi mesatarisht 33 tonë, ndërsa është importuar 4.3 mil. € dhe mesatarisht 20 mijë tonë.

Tabela 12: Eksporti dhe importi i shalqirit

		2021	2022	2023
Eksporti	Vlera në '000 €	4	13	6
	Sasia në tonë	9	79	11
	Vlera për njësi të shalqirit të freskët të eksportuar (€/kg)	0.42	0.16	0.53
	Vlera për njësi të shalqirit jo të freskët të eksportuar (€/kg)	-	-	-
Importi	Vlera në '000 €	3,790	3,352	5,750
	Sasia në tonë	25,364	18,175	17,581
	Vlera për njësi të shalqirit të freskët të importuar (€/kg)	0.15	0.18	0.33
	Vlera për njësi të shalqirit jo të freskët të importuar (€/kg)	-	-	-


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Mesatarja e vlerës për njësi të eksportuar ishte 0.37 €/kg, ndërsa vlera për njësi të importuar ishte 0.22 €/kg.

Eksporti i shalqirit

Në vitin 2022 kishte rritje të konsiderueshme të eksportit të shalqirit e cila u pasuar me ulje në vitin 2023. Ndryshime në vlerë nuk ishin të njëjta sikur ndryshimet në sasi sepse vlera për njësi të eksportuar ishte dukshëm më e lartë e që ndikoi që vlera e eksportit vetëm të zvogëlohet për 54% përkundër rënie shumë të madhe në sasi.


Figura 46: Eksporti i shalqirit 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksporti të kulturës së shalqirit kishte vetëm në kohën e vjeljes së tij, ashtu si shihet edhe në figurën e mëposhtme.


Figura 47: Eksporti i shalqirit sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksporti i shalqirit në vitin 2022, është realizuar në Mal të Zi me 95% të vlerës së përgjithshme të eksportit dhe në Maqedonia e veriut me 5%, ndërsa në vitin 2023, e tërë sasia e shalqirit është eksportuar në Austri 50%, Gjermania 49% dhe shtete të tjera vetëm 1%.

Figura 48: Eksporti i shalqirit sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR


Importi i shalqirit

Për të përmbushur kërkesën e tregut vendor për konsum të vazhdueshëm, është bërë e domosdoshme të realizohet importi i shalqirit. Prodhimi i brendshëm nuk ka arritur të sigurojë sasinë e nevojshme për tregun, çka ka ndikuar që në vazhdimësi të importohet nga vende të huaja por që sasia ka qenë në rënie.

Sipas të dhënave të importit të shalqirit, shihet se sasia e importuar vazhdimisht ka pësuar rënie, kështu në vitin 2022, sasia e importuar u zvogëluar për 28.3% në raport me vitin 2021, ndërsa në vitin 2023, për 3.3% në raport me vitin 2022. Përkundër rënies në sasi vlera në vitin 2023 ka shënuar rritje për 71.5% për shkak të vlerës më të lartë për njësi të importuar që ishte

0.33 €/kg apo 0.11 €/kg më e lartë sesa mesatarja e vlerës së importit për njësi që ishte 0.22 €/kg.


Figura 49: Importi i shalqirit 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Shalqiri është kulturë stinore dhe kërkesa për të rritet sidomos gjatë muajve të verës, dhe sasia më e madhe e importuar është regjistruar në muajin korrik të secilit vit të analizës (2021-2023).


Figura 50: Importi i shalqirit sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi më i madh gjatë vitit 2022, është realizuar nga Shqipëria me 70% të vlerës së përgjithshme të importit, e pasuar nga Greqia me 23%, Turqia me 6%, dhe vendet e tjera me 1%. Në vitin 2023, ndryshojnë pjesëmarrjet e vendeve prej nga u importua gjatë, ku Shqipëria ka pjesëmarrje me 69% të vlerës së përgjithshme të importit, e pasuar nga Greqia me 23%, Turqia me 4%, dhe vendet e tjera me 4%.

Figura 51: Importi i shalqirit sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2.1.7 Eksporti dhe importi i lakrës

Kultura e lakrës renditet në mesin e kulturave më të eksportuara edhe pse bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ sipas të dhënave të eksportit dhe importit të lakrës për periudhën 2021-2023.

Përderisa në vitin 2022, vlera e eksportit të kësaj kulture kishte rritje për 28.5% në raport me vitin 2021, në vitin 2023 pësoi rënie në krahasim me të dyja vitet paraprake (2021 dhe 2022). Rritja është vërejtur edhe tek sasia e eksportuar në vitin 2022, në raport me vitin 2021 e që është pasuar me rënie në vitin 2023. Një rënie është vërejtur edhe tek importi i kulturës së lakrës, ku në vitin 2023 sasia e importuar për lakër ishte 29.5% më e ulët, në krahasim me vitin 2022 apo 141 mijë € më pak.

Tabela 13: Eksporti dhe importi i lakrës

		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	388	499	111
	Sasia në tonë	1,765	2,450	498
	Vlera për njësi të lakrës së freskët të eksportuar (€/kg)	0.22	0.20	0.22
	Vlera për njësi të lakrës jo të freskët të eksportuar (€/kg)	-	-	-
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	1,354	1,782	1,641
	Sasia në tonë	5,989	7,451	5,250
	Vlera për njësi të lakrës së freskët të importuar (€/kg)	0.23	0.24	0.31
	Vlera për njësi të lakrës jo të freskët të importuar (€/kg)	-	-	-


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Vlera mesatare për njësi të eksportit të lakrës për periudhën 2021-2023, ishte 0.22 €/kg dhe pothuajse e njëjtë ishte edhe vlera mesatare për njësi të importit për po të njëjtën periudhë, me 0.26 €/kg, apo vetëm 0.04 €/kg diferencë.

Eksporti i lakrës

Në vitin 2023, eksporti i lakrës ka shënuar rënie të madhe, pra vlera e eksportit në vitin 2023, kishte rënie rreth 4.5 herë krahasuar me vitin 2022.

Figura 52: Eksporti i lakrës 2021-2023




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Lëvizja e vlerës së eksportit për njësi të lakrës tregon se në vitin 2022, kjo vlerë ishte më e ulët për 7.4%, në krahasim me vitin 2021 dhe në vitin 2023 më e lartë për 9.8% në krahasim me vitin 2022.

Tremujori i fundit i vitit 2023, ka regjistruar sasinë më të madhe të eksportuar, që përfshinë periudhën e vjeljes së kësaj kulture. Mirëpo ka periudha të caktuara të vitit kur nuk është regjistruar fare eksport i kulturës së lakrës varësisht nga viti.


Figura 53: Eksporti i lakrës sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Vendet ku është bërë eksporti më i madh gjatë vitit 2022 janë: Serbia me 61% të vlerës së përgjithshme të eksportit, e pasuar nga Bosnja dhe Hercegovina me 17%, Mali i Zi me 6%, Austria me 5%, Maqedonia e Veriut me 4%, dhe vendet e tjera me 7%.

Figura 54: Eksporti i lakrës sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Ndërsa, eksporti gjatë vitit 2023, është realizuar si vijon: Serbia me 22% të vlerës së përgjithshme të eksportit, e pasuar nga Bosnja dhe Hercegovina me 18%, Kroacia me 17%, Rumania me 16%, Austria me 11%, Maqedonia e Veriut me 8% dhe vendet e tjera me 8%.

Importi i lakrës

Importi i kulturës së lakrës në vlerë ka shënuar rënie për 7.9% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022. Prej të dhënave të regjistruara rrjedh se sasia e importuar në vitin 2023, pësoi një rënie për 29.5% në krahasim me vitin 2022, ndërsa vërehet se vlera për njësi të importit të lakrës kishte rritje sipas viteve duke shënuar vlerën më të lartë në vitin 2023, për 38.3%, në krahasim me vitin 2021 dhe për 30.7% në krahasim me vitin 2022.


Figura 55: Importi i lakrës 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Kërkesat e tregut për kulturën e lakrës janë paraqitur në masë të madhe në pjesën e parë të secilës periudhë raportuese, mirëpo në muajin prill të vitit 2021 dhe vitit 2022, dhe në muajin mars të vitit 2023, janë regjistruar vlerat më të larta të sasisë së importuar të lakrës në vendin tonë.

Figura 56: Importi i lakrës sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Nga vendet që është realizuar pjesa më e madhe e importit gjatë vitit 2022, janë: Shqipëria me 81% të vlerës së përgjithshme të importit, Maqedonia e Veriut me 13%, Turqia me 3%, Gjermania, Holanda dhe vendet e tjera me nga 1%.

Nëse krahasohen vendet prej nga është importuar në vitin 2022 dhe vitin 2023, del se në të dyja vitet janë pothuajse vendet e njëjta, ndërsa përqindja e pjesëmarrjes ndryshon, si: Shqipëria prin me 85% të vlerës së përgjithshme, e pasuar nga Maqedonia e Veriut me 12%, Turqia, Holanda dhe vendet e tjera me përqindje të njëjta me 1%.

Figura 57: Importi i lakrës sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2.1.8 Eksporti dhe importi i domates

Kultivimi i domates është një traditë e gjatë në Kosovë, megjithatë prodhimi vendas mbetet relativisht i ulët krahasuar me nevojat e konsumatorëve. Edhe pse në vitin 2023, është vërejtur një reduktim i vogël i sipërfaqes së mbjellë me domate, eksportet kanë shënuar rritje. Nga ana tjetër, importi është rritur ndjeshëm për të plotësuar kërkesën e tregut vendor. Kjo ka rezultuar në një bilanc tregtar negativ dhe në thellim për periudhën 2021-2023, duke treguar varësinë e tregut nga produktet e jashtme.

Tabela 14: Eksporti dhe importi i domates

		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	73	215	603
	Sasia në tonë	137	501	1,055
	Vlera për njësi të domates së freskët të eksportuar (€/kg)	0.53	0.44	0.57
	Vlera për njësi të domates jo të freskët të eksportuar (€/kg)	0.85	0.15	-
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	6,459	6,819	11,955
	Sasia në tonë	18,686	13,182	16,586
	Vlera për njësi të domates së freskët të importuar (€/kg)	0.35	0.52	0.72
	Vlera për njësi të domates jo të freskët të importuar (€/kg)	3.01	4.83	6.42


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në tabelën më lartë shohim se vlerat e eksportit në vazhdim kanë shënuar një rritje, përderisa vlera e importit pas rënies në vitin 2021, kanë vazhduar të ngritën në vitin 2022 dhe 2023.

Eksporti i domates

Në vitin 2023, sasia e eksportuar ka ngritje për 2 herë më shume se sa në vitin 2022, ndërsa vlera për njësi të domates së freskët të eksportuar ishte më e lartë për 30%, në krahasim me vitin 2022. Ndërsa gjatë vitit 2021 dhe 2022, ka pasur edhe eksport të domates jo të freskët të eksportuar, për dallim nga viti 2023 ku nuk kemi pas fare eksport të domates jo të freskët.


Figura 58: Eksporti i domates 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në muajin korrik të vitit 2023, është regjistruar sasia më e lartë e eksportuar në tre vitet e fundit plot 777 tonë. Kjo sasi është 55% më shumë se sasia e eksportuar gjatë gjithë vitit 2022 dhe shumë më e madhe krahasuar me vitin 2021. Në pjesën tjetër të vitit ka muaj që nuk ka pasur fare eksport.


Figura 59: Eksporti i domates sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sasia e eksportit ishte e vogël në vitin 2022, me 501 tonë, dhe u realizua në këto vende: Maqedoni e Veriut (46%), Suedi (12%), Shqipëri (8%), Serbi (7%), Bosnje dhe Hercegovinë (7%) dhe vende të tjera (14%), ndërsa në vitin 2023 sasia e eksportuar ishte 1,055 tonë, vendet e eksportit ishin pothuajse të njëjta por printe Maqedonia e Veriut me 38%, Mali i Zi me 26%, Bulgaria 9%, Bosnja dhe Hercegovina 9%, Shqipëria 5% dhe vendet e tjera me 13%.

Figura 60: Eksporti i domates sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i domates

Për shkak të mungesës së prodhimit vendor të domates, importi i kësaj kulture ka qenë i nevojshëm për të përmbushur kërkesat e tregut. Domatja renditet e para në grupin e perimeve më të importuara. Të dhënat e importit tregojnë se në vitin 2023, sasia e domates së importuar është rritur me 25.8%, në krahasim me vitin 2022.


Figura 61: Importi i domates 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Vlera për njësi e domates së freskët të importuar ishte 0.52 €/kg, në vitin 2022 ndërsa në vitin 2023 vlera për njësi të domates së freskët ishte ngritur në 0.72 €/kg. Vlera për njësi e domates jo të freskët të importuar paraqet një lëvizje në ngritje nga 3.01 €/kg në vitin 2021, në 4.83 €/kg në vitin 2022, si dhe 6.42 €/kg në vitin 2023.

Figura 62: Importi i domates sipas muajve, në '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Ashtu siç shihet edhe në figurën 62, kërkesa e tregut për domate paraqitet më e theksuar në gjashtë mujorin e parë ku pika më e lartë është kryesisht në muajin maj, ndërsa në pjesë e dytë të vitit kur edhe fillon vjelja e prodhimit vendor, bie kjo kërkesë, mirëpo vazhdon të mos ketë shpëputje të importit.

Vendet prej nga është importuar më së shumti në vitin 2022, janë: Turqia (53%), Shqipëria (43%), Maqedonia e Veriut (2%), Holanda (1%) dhe vendet e tjera (1%), po ashtu edhe në vitin 2023, janë Turqia (51%), Shqipëria (43%), Maqedonia e Veriut (4%), Greqia (1%) dhe të tjerat (1%).

Figura 63: Importi i domates sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

2.1.9 Eksporti dhe importi i trangullit

Kultura e trangullit renditet e fundit në listën e dhjetë kulturave më të kultivuara të perimeve në Kosovë gjatë vitit 2023, ndërsa tregtimi i saj e rendit të gjashtë në listën e eksportit të perimeve dhe të shtatën në listën e importit, bilanci tregtar i së cilës është negativ.

Tabela 15: Eksporti dhe importi i trangullit

		2021	2022	2023
<i>Eksporti</i>	Vlera në '000 €	590	380	218
	Sasia në tonë	965	694	384
	Vlera për njësi të trangullit të freskët të eksportuar (€/kg)	0.61	0.55	0.57
	Vlera për njësi të trangullit jo të freskët të eksportuar (€/kg)	0.68	-	-
<i>Importi</i>	Vlera në '000 €	2,145	2,572	3,046
	Sasia në tonë	5,711	5,870	5,414
	Vlera për njësi të trangullit të freskët të importuar (€/kg)	0.38	0.44	0.57
	Vlera për njësi të trangullit jo të freskët të importuar (€/kg)	0.93	0.22	-

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR


Të dhënat e eksportit dhe importit të kulturës së trangullit, tregojnë se kishte rënie të eksportit ndër vite po ashtu edhe bilanci tregtar ka vazhduar të mbetet negativ duke qenë se vlera e importit ka shënuar rritje të vazhdueshme.

Derisa sasia e eksportit të trangullit në vitin 2023, është zvogëluar për 45%, në krahasim me vitin 2022, po ashtu edhe importi është zvogëluar por vetëm për 8%. Vlera mesatare për njësi të eksportit të trangullit të freskët për periudhën 2021-2023 është 0.58 €/kg, dhe ajo e importit të trangullit të freskët për po të njëjtën periudhë është 0.46 €/kg, ndërsa vlera mesatare për njësi të eksportit të trangullit jo të freskët është 0.68 €/kg për vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 dhe 2023 nuk kemi pasur fare eksport.

Eksporti i trangullit

Figura 64 prezanton situatë në rënie të vlerës në € dhe sasisë në tonë, por edhe ndryshimet e vlerës për njësi të trangullit të freskët dhe jo të freskët. Sasia e trangullit të eksportuar në vitin 2023, është zvogëluar për 45% apo për 161 mijë €, ndërsa vlera për njësi të eksportuar të trangullit të freskët për periudhën 2021-2023 është 0.58 €/kg, ndërsa vlera për njësi të eksportuar të trangullit jo të freskët është 0.68 €/kg për vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 dhe 2023 nuk ka pasur sasi të eksportuar.


Figura 64: Eksporti i trangullit 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sasia më e madhe e eksportit të trangullit, është realizuar në muajt qershor dhe korrik, gjatë gjithë periudhës 2021-2023.


Figura 65: Eksporti i trangullit sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Eksporti i trangullit nëpër shtete, në vitin 2022 është realizuar për 49% të vlerës së përgjithshme të tij në Poloni 49%, pasuar me 13% në Republikën Çeke, 13% në Serbi, 11% në Kroaci, 5% në Bosnje edhe Hercegovinë dhe në vendet e tjera 9%, ndërsa në vitin 2023 kemi këto vende: Polonia 54%, Kroacia 17%, Mali i Zi 13%, Shqipëria 5% dhe vendet e tjera 11%.

Figura 66: Eksporti i trangullit sipas shteteve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i trangullit

Kërkesa e tregut për kulturën e trangullit ka qenë e madhe dhe për përmbushjen e saj është nevojitur të importohet sasi e konsiderueshme, ku në vitin 2023, vlera e importit është rritur për 18.5%, në krahasim me vitin 2022, por edhe vlera për njësi e importit të trangullit të freskët ishte rritur për 30% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, ndërsa vlera për njësi e importit të trangullit jo të freskët ishte zvogëluar për 77% në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021, kurse në vitin 2023 nuk ka pasur import të trangullit jo të freskët.


Figura 67: Importi i trangullit 2021-2023



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sipas të dhënave të analizës (2021-2023), në pjesën e parë të vitit për të përmbushur kërkesën është realizuar shumica e importit të trangullit për të pasuar me ulje në pjesën e dytë të vitit, pjesa më e madhe e kërkesës për import ka qenë në muajin prill dhe maj.


Figura 68: Importi i trangullit sipas muajve, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në rast se krahasojmë vendet e importit të vitit 2022 dhe 2023, del se vendet prej nga është realizuar importi për të dyja vitet mbeten pothuajse të njëjta mirëpo ndryshojnë vlerat e përqindjeve. Vlera më e lartë e importit është nga Shqipëria me 74% në vitin 2022, pasuar nga Turqia me 14%, Greqia me 9% dhe Maqedonia e Veriut 3%. Pjesëmarrja në importin e vitit 2023, ishte me 75% Shqipëria, 16% Turqia, 8% Greqia dhe vendet e tjera 1%.

Figura 69: Importi i trangullit sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

3 Çmimet e kulturave perimtare

Në këtë kapitull janë paraqitur çmimet e dhjetë kulturave perimtare më të kultivuara në Kosovë, për të cilat do të flasim më hollësisht në vijim. Çmimet janë të paraqitura në nivel të fermës, në nivel të shitjes me shumicë dhe në nivel të shitjes me pakicë, për periudhën 2021-2023.

Tabela 16: Çmimet e kulturave perimtare 2022-2023


	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023/2022 (%)
<i>Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg</i>				
Patate	0.42	0.49	0.48	-2
Spec	0.62	0.78	0.70	-10
Fasule	2.38	2.49	3.50	41
Kungull	0.16	0.25	0.30	20
Qepë	0.41	0.48	0.46	-4
Shalqi	0.21	0.21	0.30	43
Lakër	0.31	0.36	0.45	25
Kungull misiri	0.29	0.39	0.35	-10
Domate	0.52	0.66	0.69	5
Trangull	0.54	0.67	0.45	-33
<i>Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg</i>				
Patate	0.40	0.51	0.48	-6
Spec	0.94	1.27	0.96	-24
Fasule	2.50	2.84	3.50	23
Kungull	0.27	0.53	0.71	34
Qepë	0.48	0.62	0.55	-11
Shalqi	0.24	0.25	0.40	60
Lakër	0.47	0.55	0.47	-15
Kungull misiri	0.46	0.69	0.46	-33
Domate	0.78	1.17	0.84	-28
Trangull	0.75	0.91	0.64	-30
<i>Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg</i>				
Patate	0.49	0.60	0.72	20
Spec	1.08	1.38	1.50	9
Fasule	2.67	3.01	4.30	43
Kungull	0.34	0.61	0.88	44
Qepë	0.57	0.71	0.82	15
Shalqi	0.28	0.28	0.50	79
Lakër	0.55	0.55	0.48	-13
Kungull misiri	0.51	0.75	0.59	-21
Domate	0.94	1.26	1.37	9
Trangull	0.86	1.06	1.00	-6

Burimi: DAESB – MBPZhR

3.1 Çmimet për kulturën e patate

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e patate në periudhën 2021-2023, ishte 0.46 €/kg, ku vërehet rënie e çmimit në vitin 2023, për vetëm 2%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.46 €/kg, ku në vitin 2023 nuk kishte ndryshim me çmimin e fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 0.60 €/kg, ose në vitin 2023 më i lartë për 50% krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë në vitin 2023.

Figura 70: Çmimet për patate në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB – MBPZhR

3.2 Çmimet për kulturën e specit

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e specit në periudhën 2021-2023, ishte 0.70 €/kg, ku vërehet ulje e çmimit në vitin 2023 për 10%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 1.06 €/kg, ku në vitin 2023, ishte për 37% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 1.32 €/kg, për vitin 2023 më i lartë për 56%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 71: Çmimet për specin në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB – MBPZhR

3.3 Çmimet për kulturën e fasules

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e fasules në periudhën 2021-2023, ishte 2.79 €/kg, ku vërehet rritje e çmimit në vitin 2023 për 41%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 2.95 €/kg, ku në vitin 2023, çmimi ishte i njëjtë me çmimin e fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 3.33 €/kg, ose në vitin 2023 më i lartë për 23%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 72: Çmimet për fasulen në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB - MBPZhR

3.4 Çmimet për kulturën e kungullit

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e kungullit në periudhën 2021-2023, ishte 0.24 €/kg, ku vërehet ngritje e çmimit në vitin 2023 për 20%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.50 €/kg, ku në vitin 2023, çmimi me shumicë ishte pak më i lartë se dyfishi i çmimit të fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë në periudhën 2021-2023 është 0.61 €/kg, ose në vitin 2023, më i lartë për 24%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 73: Çmimet për kungullin në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB - MBPZhR

3.5 Çmimet për kulturën e qepës

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e qepës në periudhën 2021-2023, ishte 0.45 €/kg, ku vërehet ulje e çmimit në vitin 2023 për 4%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.55 €/kg, ku në vitin 2023, ishte për 20% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 0.70 €/kg, ose në vitin 2023 më i lartë për 49%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 74: Çmimet për qepën në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB – MBPZhR

3.6 Çmimet për kulturën e shalqirit

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e shalqirit në periudhën 2021-2023, ishte 0.24 €/kg, ku vërehet rritje e çmimit në vitin 2023 për 43%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.30 €/kg, ku në vitin 2023, ishte për 33% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 0.35 €/kg, ose në vitin 2023 më i lartë për 25%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 75: Çmimet për shalqi në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB – MBPZhR

3.7 Çmimet për kulturën e lakrës

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e lakrës në periudhën 2021-2023, ishte 0.37 €/kg, ku vërehet rritje e çmimit në vitin 2023, për 25%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.50 €/kg, ku në vitin 2023, ishte për 4% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 0.53 €/kg, ose në vitin 2023 më i lartë për 2%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 76: Çmimet për lakër në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB - MBPZhR

3.8 Çmimet për kulturën e kungullit të misirit

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e kungullit të misirit në periudhën 2021-2023, ishte 0.34 €/kg, ku vërehet ulje e çmimit në vitin 2023 për 10%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.54 €/kg, ku në vitin 2023, ishte për 31% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 0.62 €/kg, ose në vitin 2023 më i lartë për 28%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 77: Çmimet për kungull të misirit në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB - MBPZhR

3.9 Çmimet për kulturën e domates

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e domates në periudhën 2021-2023, ishte 0.62 €/kg, ku vërehet rritje e çmimit në vitin 2023 për 5%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.93 €/kg, ku në vitin 2023, ishte për 22% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 1.19 €/kg, ose në vitin 2023 më i lartë për 63%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 78: Çmimet për domate në €/kg, 2021-2023




Burimi: DAESB - MBPZhR

3.10 Çmimet për kulturën e trangullit

Çmimi mesatar i fermës për kulturën e trangullit në periudhën 2021-2023, ishte 0.55 €/kg, ku vërehet rënie e çmimit në vitin 2023, për 33%, në krahasim me vitin 2022. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për këtë periudhë është 0.77 €/kg, ku në vitin 2023, ishte për 42% më i lartë sesa çmimi i fermës, ndërsa çmimi mesatar i shitjes me pakicë është 0.97 €/kg, ose në vitin 2023 më i lartë për 56%, krahasuar me çmimin mesatar të shitjes me shumicë.

Figura 79: Çmimet për tranguj në €/kg, 2021-2023



Burimi: DAESB - MBPZhR

4 Mbështetja direkte për sektorin e perimeve

Me qëllim përmirësimin e sektorit të bujqësisë dhe rritjen e konkurrencës në treg, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural çdo vit shpërndan mjete financiare për fermerët përmes Programit të Pagesave Direkte dhe Programit për Zhvillim Rural.

Në këtë kapitull do të fokusohemi në të dhënat që lidhen me Programin e Pagesave Direkte dhe Programin e Zhvillimit Rural, të cilat konsiderohet si një mbështetje e drejtpërdrejtë për fermerët, realizuar për sipërfaqet e mbjella sipas kulturave përkatëse dhe mënyrës së kultivimit si dhe investimet e bëra në sektorin e perimeve.

Mbështetja financiare (pagesa për hektar), për perimet e kultivuara në fushë të hapur, në vitin 2021, ka qenë 400 €/ha për të gjitha perime në fushë të hapur, por në vitin 2022, kemi diferenca në vlerat e pagesave direkte për sipërfaqe për sektorin e perimeve, ku për kungujt dhe kunguj misiri pagesa ishte 204 €/ha, për patate dhe fasule 654 €/ha dhe për të gjitha perimet e tjera pagesa ishte 554 €/ha. Po ashtu edhe në vitin 2023, e kemi të njëjtën mbështetje financiare për perimet në fushë të hapur, mirëpo kishte rënie të numrit të aplikuesve për 9.9%, si dhe rënie të sipërfaqes së paguar (hektarëve) për 14.6% në vitin 2023, për dallim me vitin 2022.

Perimet e kultivuara në serra në vitin 2023, kishin rritje të numrit të aplikuesve për këtë kategori të kultivimit të perimeve për 15% në raport me vitin 2022, ku gjithashtu u shënuar rritje e sipërfaqes së paguar (hektarëve) për 15.7% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022.

Kulturat perimtare të kultivuara sipas mënyrës organike dhe të certifikuara, në vitin 2023 u mbështeten me 100 € shtesë të pagesës bazë për kulturën e kultivuar dhe në vitin 2023 ishte vetëm 1 përfitues për sipërfaqe 0.18 ha, i cili u mbështet me 654 € për hektar. Mbështetja për bujqësi organike ishte rritur për 100%, nga 50 €/ha shtesë që ishte në vitin 2022.

Tabela 17: Pagesat direkte për sektorin e perimeve 2022-2023


		2021	2022	2023
<i>Perime në fushë të hapur</i>	Numri i aplikuesve	3,811	4,194	3,777
	Numri i përfituesve	3,700	4,007	3,531
	Numri i ha të paguar	6,708	6,813	5,815
	Pagesa për ha	400	204/554/654	204/554/654
	Shuma totale e paguar	2,683,388	3,439,367	2,998,619
<i>Perime në serra</i>	Numri i aplikuesve	350	521	599
	Numri i përfituesve	339	497	539
	Numri i ha të paguar	162	201	232
	Pagesa për ha	500	904	904
	Shuma totale e paguar	80,990	181,342	209,728
<i>Bujqësi organike - Perime</i>	Numri i aplikuesve	-	3	2
	Numri i përfituesve	-	1	1
	Numri i ha të paguar	-	0.83	0.18
	Pagesa për ha	450	604	654
	Shuma totale e paguar	-	501	118

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2023, kishte diferenca në pagesë sipas kulturës së kultivuar. Të gjithë kultivuesit e perimeve u mbështetën në shumë prej 204/554/654 €/ha dhe vlera totale e pagesave të realizuara për këta kultivues ishte rreth 3 mil. €.

Në gjithsej buxhetin e realizuar për periudhën 2021-2023, për subvencionimin e bujqve përmes PPD, pjesëmarrja mesatare e sektorit të perimeve ishte 7%, ku përfshihen pagesat për sipërfaqen në fushë të hapur, sipërfaqen në serra dhe sipërfaqen e perimeve të kultivuara në mënyrë organike. Në vitin 2023 u shënuar pjesëmarrja më e ulët e subvencionimit për kultivuesit e perimeve në gjithsej pagesat direkte të realizuara, me ulje prej 1.2 pikë përqindje në raport me vitin 2022, dhe me ulje 3.3 pikë përqindje në raport me vitin 2021.


Figura 80: Pjesëmarrja e kulturave perimtare në gjithsej pagesat direkte



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2023, shuma e përgjithshme e pagesave direkte ishte për 5.5 mil. € më e lartë sesa në vitin 2022 apo 9.6% më e lartë, ndërsa gjithsej shuma e pagesave të realizuara për subvencionimin e kultivuesve të perimeve në vitin 2023, ishte për 11% më e ulët sesa në vitin 2022.

Figura 81: Shpërndarja e pagesave direkte sipas kulturave perimtare (%)



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2023, nga gjithsej pagesat direkte për kultura perimtare, 32% janë për patate, 19% për spec, 8% për qepë, 7% për shalqi, 7% për lakër, 7% për fasule, 6% kunguj, 5% kunguj misiri dhe 9% për kulturat e tjera perimtare. Këto kultura paraqesin 90.9% të pjesëmarrjes në gjithsej kulturat perimtare të subvencionuara gjatë vitit 2023. Shpërndarja për vitin 2022, për kulturat perimtare ka pak ndryshime dhe është si në vijim: 24% për patate, 19% për spec, 14% kunguj, 9% kunguj misiri, 8% për lakër, 7% për shalqinj, 6% për qepë, 5% për fasule dhe 8% për kulturat e tjera perimtare. Këto kultura paraqesin 91.9% të pjesëmarrjes në gjithsej kulturat perimtare të subvencionuara gjatë vitit 2022.

4.1 Mbështetja direkte për pataten

Në vitin 2023, numri i aplikuesve për mbështetje direkte për kulturën e patates kishte rritje për 16.2%, në krahasim me vitin 2022, ndërsa numri i përftuesve u rrit për 14.2% që rezultoi me % më të lartë të fermerëve të refuzuar.

Nga fermerët që aplikuan për patate në kuadër të PPD 2023, 95% e tyre ishin përfitues të kësaj mbështetje financiare dhe 5% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve, me ç'rast në vitin 2023 u subvencionuan 1,867 ha, apo 13.5% më shumë sesa në vitin 2022.

Përkundër se numri i hektarëve ishte më i madh në vitin 2023, shuma totale e pagesave direkte ishte më e ulët për 3.8% sepse për dallim nga viti 2022 kur pagesa për pleh në shumën 100 €/ha ishte e përfshirë në pagesën bazë për ha, në vitin 2023 mbështetja për pleh u realizuar në bazë të dëshmisë së sjell (faturës) dhe u realizuar si pagesë shtesë.


Tabela 18: Pagesa direkte për pataten, 2021-2023

	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	818	994	1,155
<i>Numri i përfituesve</i>	798	958	1,094
<i>Numri i ha të paguar</i>	1,596	1,644	1,867
<i>Pagesa për ha</i>	400	654	554
<i>Shuma totale e paguar</i>	638,216	1,075,300	1,034,085

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Aplikuesit për kulturën e patates për PPD ndër vite, pavarësisht numrit të tyre në ngritje (në vitin 2022 për 21.5% në krahasim me vitin 2021), dhe prapë një ngritje (në vitin 2023 për 16.2% në krahasim me vitin 2022), përqindja mesatare e përfituesve për kulturën e patates në periudhën 2021-2023 është 96%, ndërsa sipërfaqja e mbështetur për të njëjtën periudhë po ashtu paraqet ngritje (në vitin 2022 për 3%, në krahasim me vitin 2021), prapë (në vitin 2023 për 13.5%, në krahasim me vitin 2022). Mesatarja e mbështetjes financiare për periudhën 2021-2023 ishte 915 mijë €.

Figura 82: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për patate



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2 Mbështetja direkte për specin

Numri i kultivuesve të specit që aplikuan për mbështetje direkte në vitin 2023, kishte rënie për 7.4% në krahasim me vitin 2022, shuma përkrahëse për hektar të kësaj kulture ishte e njëjtë në krahasim me vitin 2022, por në krahasim me vitin 2021 ishte 38.5% më e lartë.


Tabela 19: Pagesa direkte për spec, 2021-2023

	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	1,201	1,344	1,244
<i>Numri i përfituesve</i>	1,169	1,298	1,183
<i>Numri i ha të paguar</i>	1,222	1,277	1,085
<i>Pagesa për ha</i>	400	554	554
<i>Shuma totale e paguar</i>	488,828	707,347	601,256

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga aplikuesit për kulturën e specit në vitin 2023, 95% ishin përfitues të mbështetjes direkte dhe 5% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve, me ç'rast në vitin 2023 u subvencionuan 1,085 ha në vlerën rreth 601 mijë €, apo 15% sipërfaqe më pak sesa në vitin 2022.

Të dhënat për vitin 2022, tregojnë numrin më të madh të aplikuesve dhe rrjedhimisht të përfituesve dhe të hektarëve të mbështetur, për këtë kulturë, në raport me vitin 2021 dhe 2023. Numri i aplikuesve për kulturën e specit ka ngritje në vitin 2022 për 11.9%, në krahasim me vitin 2021, dhe rënie në vitin 2023 për 7.4%, në krahasim me vitin 2022 dhe rritje për 3.6%, në krahasim me vitin 2021. Përqindja mesatare e përfituesve për kulturën e specit në periudhën 2021-2023, është 96%, ndërsa sipërfaqja e subvencionuar për të njëjtën periudhë paraqitet me rritje në vitin 2022 për 4.4%, në krahasim me vitin 2021, dhe zvogëlim të hektarëve të mbjellë në vitin 2023 për 15%, në krahasim me vitin 2022.

Figura 83: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për spec

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.3 Mbështetja direkte për fasulen

Në vitin 2023, shuma totale e mbështetjes direkte për kulturën e fasules është më e vogël në krahasim me vitin 2022, për shkak se pagesa për pleh në vlerë prej 100 €/ha nuk është paguar në kuadër të pagesës bazë për hektarë si ishte në vitin 2022, por si pagesë shtesë në bazë të

dëshmime të sjella, andaj përkundër asaj se sipërfaqja e subvencionuar është rritur, gjithsej shuma e paguar është më e ulët. Numri i aplikuesve për këtë kulturë është rritur për 19.4% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, dhe 43.8% në krahasim me vitin 2021.

Tabela 20: Pagesa direkte për fasule, 2021-2023

	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	304	366	437
<i>Numri i përfituesve</i>	290	342	365
<i>Numri i ha të paguar</i>	291	363	413
<i>Pagesa për ha</i>	400	654	554
<i>Shuma totale e paguar</i>	116,588	237,140	228,835


Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Përderisa në vitin 2022, mbështetja financiare për kulturën e fasules ishte 121 mijë € më shumë sesa në vitin 2021, me ç'rast ishin 52 fermer përfitues më shumë dhe kishte 71 ha më shumë të subvencionuar. Në vitin 2023 u subvencionuan 50 ha sipërfaqe më shumë sesa në vitin 2022, dhe kishte 23 fermer përfitues më shumë por kishte ulje të gjithsej vlerës së mbështetjes për shkak të pagesës për pleh që është realizuar si pagesë shtesë.

Nga numri i përgjithshëm i aplikuesve, 84% e tyre ishin përfitues të mbështetjes financiare dhe 16% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve, me ç'rast në vitin 2023 u subvencionuan 413 ha, apo 14% më shumë sesa në vitin 2022.

Përqindja mesatare e përfituesve të mbështetjes direkte për kulturën e fasules në periudhën 2021-2023 është 91%, ndërsa shuma mesatare e mbështetjes financiare për të njëjtën periudhë është 194 mijë €, me numër më të madh të hektarëve të subvencionuar në vitin 2022 për 24.4%, në krahasim me vitin 2021 dhe rritje të hektarëve të subvencionuar në vitin 2023 për 13.9%, në krahasim me vitin 2022, ndërsa krahasuar me vitin 2021, rritja në vitin 2023 ishte 41.7%.

Figura 84: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për fasule



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.4 Mbështetja direkte për kungullin

Kultivimi i kungullit ka shënuar rënie ndër vite, por në vitin 2023, si rezultat i kësaj rënie ka rënë edhe numri i aplikuesve për 51.5%, në krahasim me vitin 2022.

Numri i aplikuesve në vitin 2022 ishte më i ulët për 11.5%, në krahasim me vitin 2021, dhe 57% më i ulët në vitin 2023 në krahasim me po të njëjtin vit.

Në vitin 2023, 89% e aplikuesve për subvencionim të kulturës së kungullit, ishin përfitues të mbështetjes financiare dhe 11% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve.

Subvencionimi gjatë vitit 2023, ishte 342 ha apo 63.2% më pak sesa në vitin 2022 si rezultat i rënies së numrit të fermerëve aplikues dhe sipërfaqeve të kultivuara.


Tabela 21: Pagesa direkte për kungull, 2021-2023

	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	1,082	958	465
<i>Numri i përfituesve</i>	1,045	915	412
<i>Numri i ha të paguar</i>	1,387	932	342
<i>Pagesa për ha</i>	400	204	204
<i>Shuma totale e paguar</i>	554,688	190,222	69,860

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Përqindja mesatare e përfituesve të mbështetjes direkte, për kulturën e kungullit në periudhën 2021-2023 është 94%, ndërsa shuma mesatare e mbështetjes financiare për të njëjtën periudhë është 272 mijë €, me rënie të numrit të hektarëve të subvencionuar për 32.8% në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021, dhe rënie të numrit të hektarëve të subvencionuar në vitin 2023 për 63.3%, në krahasim me vitin 2022.

Figura 85: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për kungull



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.5 Mbështetja direkte për qepën

Viti 2023, shënon rritje të numrit të aplikuesve për kulturën e qepës për 4.1%, në krahasim me vitin 2022, ndërsa në vitin 2023 kishte ngritje të numrit të aplikuesve për 31.3%, në krahasim me vitin 2021, dhe shuma e mbështetjes financiare ishte rritur për 38.5%.

Nga numri i përgjithshëm i aplikuesve për këtë kulturë, 96% e tyre ishin përfitues të PPD 2023, duke mbështetur kështu 448 ha të mbjellë me një total prej 248 mijë €, apo rreth 25 mijë € më shumë sesa në vitin 2022, mirëpo më shumë se 83 mijë €, në krahasim me vitin 2021.


Tabela 22: Pagesa direkte për qepë, 2021-2023

	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	483	609	634
<i>Numri i përfituesve</i>	475	577	611
<i>Numri i ha të paguar</i>	410	402	448
<i>Pagesa për ha</i>	400	554	554
<i>Shuma totale e paguar</i>	164,176	222,968	247,981

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Të dhënat për vitin 2023, tregojnë numër më të madh dhe një interesim të aplikuesve për mbështetje për kulturën e qepës. Përqindja mesatare e përfituesve të mbështetjes direkte për kulturën e qepës në periudhën 2021-2023, është 96%, ndërsa shuma mesatare e mbështetjes për të njëjtën periudhë është 212 mijë €, me rritje të numrit të hektarëve të subvencionuar në vitin 2023 për 11.2%, në krahasim me vitin 2022 dhe pas rënies në vitin 2022 për 1.9%, në krahasim me vitin 2021.

Figura 86: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për qepë



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.6 Mbështetja direkte për shalqirin

Në vitin 2023, numri i aplikuesve për mbështetje direkte për kulturën e shalqirit ishte 5.2% më i ulët sesa në vitin 2022, përderisa në vitin 2022 kjo kulturë kishte rritje të numrit të aplikuesve për 4.6%, në krahasim me vitin 2021.

Vlera e mbështetjes direkte për hektar ishte e njëjtë si në vitin paraprak por kishte shënuar rritje në vitin 2023 për 38.5%, në krahasim me vitin 2021, por kishte rënie të interesimit për kultivimin të kësaj kulture.

Tabela 23: Pagesa direkte për shalqi, 2021-2023


	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	582	609	577
<i>Numri i përfituesve</i>	568	581	562
<i>Numri i ha të paguar</i>	523	472	435
<i>Pagesa për ha</i>	400	554	554
<i>Shuma totale e paguar</i>	209,268	261,649	240,940

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga numri i përgjithshëm i aplikuesve, 97% ishin përfitues, që nënkupton se vetëm 3% u refuzuan për shkak të mos kompletimit të duhur të dokumentacionit, pra u subvencionuan 435 ha apo 7.9% më pak sesa në vitin 2022, si rezultat i rënies së numrit të fermerëve aplikues.

Përqindja mesatare e përfituesve të mbështetjes direkte për kulturën e shalqirit në periudhën 2021-2023, është 97%, ndërsa shuma mesatare mbështetjes për të njëjtën periudhë është 237 mijë €, me rënie të numrit të hektarëve të subvencionuar për 16.9% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2021 dhe rënie të numrit të hektarëve të subvencionuar në vitin 2022 për 9.7%, në krahasim me vitin 2021.

Figura 87: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për shalqi



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.7 Mbështetja direkte për lakrën

Rënia e numrit të aplikuesve, për mbështetje financiare për kulturën e lakrës, në vitin 2023 është 25%, në krahasim me vitin 2022 edhe pse në PPD 2023, shuma për mbështetjen e kësaj kulture ishte rritur për 38.5%, në krahasim me vitin 2021.

Rënia e numrit të aplikuesve tregon se në vitin 2023 u subvencionuan 29.6% sipërfaqe më pak se në vitin 2022, ose 4.8% më shumë se në vitin 2021. Përfitues në vitin 2023 ishin 97% e aplikuesve të kësaj kulture dhe u mbështetën financiarisht 404 ha.


Tabela 24: Pagesa direkte për lakër, 2021-2023

	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	483	770	578
<i>Numri i përfituesve</i>	469	732	561
<i>Numri i ha të paguar</i>	373	574	404
<i>Pagesa për ha</i>	400	554	554
<i>Shuma totale e paguar</i>	149,064	317,974	223,877

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Përqindja mesatare e përfituesve të mbështetjes direkte për kulturën e lakrës në periudhën 2021-2023, është 96%, ndërsa shuma mesatare e mbështetjes për të njëjtën periudhë është 230 mijë € për mesatarisht 450 ha.

Figura 88: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për lakër



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.8 Mbështetja direkte për kungullin e misirit

Mbështetja direkte për kungull të misirit shënon rënie në vitin 2023 për 50.8%, në krahasim me vitin 2022, pas rënies prej 34.2% që ishte në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021. Rënia në vitin 2023 është si rezultat i numrit më të vogël të aplikuesve dhe përfituesve e njëkohësisht hektarëve të subvencionuar, e që dallon nga rënia e gjithsej shumës së paguar në vitin 2022, për shkak të uljes së pagesës për hektar.

Tabela 25: Pagesa direkte për kungull misiri, 2021-2023


	2021	2022	2023
Numri i aplikuesve	524	676	404
Numri i përfituesve	513	655	385
Numri i ha të paguar	464	599	295
Pagesa për ha	400	204	204
Shuma totale e paguar	185,508	122,139	60,141

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Prej numrit të përgjithshëm të aplikuesve për këtë kulturë, 95% e tyre ishin përfitues të mbështetjes financiare dhe 5% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve, me ç'rast në vitin 2023 u subvencionuan 295 ha, apo 50.8% më pak sesa në vitin 2022.

Sa i përket aplikuesve të kulturës së kungullit për PPD në periudhën 2021-2023, pjesëmarrja mesatare e përfituesve të mbështetjes direkte për këtë kulturë është 97%, ndërsa shuma mesatare e mbështetjes për të njëjtën periudhë ishte 123 mijë €.

Mbështetja financiare më e madhe për kulturën e kungullit të misirit u shënuar në vitin 2021 me 186 mijë € për 464 ha, ndërsa në vitin 2022 u shënuar një rënie për 34.2% në vlerë totale të mbështetjes financiare, në krahasim me vitin 2021 dhe në vitin 2023 me 50.8% më pak, në krahasim me vitin 2022.

Figura 89: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për kungull misiri

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.9 Mbështetja direkte për domaten

Numri i aplikuesve për kulturën e domates në vitin 2023, ka rënie 5.7%, në krahasim me vitin 2022, edhe pse shuma e përkrahjes për hektar të kultivuar me këtë kulturë, në vitin 2022 dhe 2023, ishte e njëjtë. Përkundër rënies së numrit të aplikuesve, numri i përfituesve ishte i njëjtë si në vitin 2022.


Tabela 26: Pagesa direkte për domate, 2021-2023

	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	48	70	66
<i>Numri i përfituesve</i>	44	61	61
<i>Numri i ha të paguar</i>	16	20	21
<i>Pagesa për ha</i>	400	554	554
<i>Shuma totale e paguar</i>	6,532	10,969	11,667

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

92% e aplikuesve për kulturën e domates në kuadër të PPD 2023, ishin përfitues të mbështetjes financiare dhe 8% u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë të dokumenteve, me ç'rast në vitin 2023 u subvencionuan vetëm 21 ha, apo 6.4% më shumë sesa në vitin 2021, si rezultat i rënies së numrit të fermerëve aplikues.

Të dhënat tregojnë se në vitin 2023, numri i hektarëve të mbështetur kishte rënie për 6.4%, në krahasim me vitin 2022 dhe për 29%, në krahasim me vitin 2021. Përqindja mesatare e përfituesve për kulturën e domates në periudhën 2021-2023, është 90%, ndërsa shuma mesatare e mbështetjes për të njëjtën periudhë është rreth 10 mijë €.

Figura 90: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për domate

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.10 Mbështetja direkte për trangullin

Kultura e trangullit vazhdimisht ka shënuar rënie të sipërfaqes së subvencionuar, e përcjell nga rënia e numrit të aplikuesve dhe përfituesve. Në vitin 2023, kishte rënie të numrit të aplikuesve për 42.1%, në krahasim me vitin 2022, edhe pse kishte rritje të vlerës së mbështetjes direkte për 38.5%, në krahasim me vitin 2021.

Tabela 27: Pagesa direkte për trangull, 2021-2023


	2021	2022	2023
<i>Numri i aplikuesve</i>	19	19	11
<i>Numri i përfituesve</i>	17	13	10
<i>Numri i ha të paguar</i>	7	4	3
<i>Pagesa për ha</i>	400	554	554
<i>Shuma totale e paguar</i>	2,772	2,415	1,596

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Prej numrit të përgjithshëm të aplikuesve në vitin 2023, 91% e tyre përfituan të drejtën e mbështetjes direkte, ku 9% u refuzuan për mos kompletim të duhur të dokumenteve ose mungesë të tyre, duke u subvencionuar kështu vetëm 3 ha, në shumë prej rreth 1.6 mijë €.

Mbështetja financiare më e madhe për kulturën e trangullit u shënuar në vitin 2021 me rreth 3 mijë € për 7 ha, ndërsa në vitin 2022 u shënuar një rënie për 37% në hektarët e mbështetur financiarisht, në krahasim me vitin 2021 dhe në vitin 2023 me 58.4% hektarë, në krahasim me vitin 2021.

Figura 91: Sipërfaqja e subvencionuar dhe shuma e paguar për trangull



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte (AZhB), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.11 Mbështetja përmes granteve për sektorin e perimeve

Programi i Zhvillimit Rural (PZhR), mbështet përmes granteve sektorin e perimtarisë bazuar në Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 15/151, Ligjin Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe në analizën e pavarur sektoriale, për sektorët kryesorë të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Bazuar në këto dokumente strategjike PZhR 2023, mbështet sektorin e perimtarisë nëpërmjet masave:

- Masa 1: Investimet në asete fizike në ekonomitë familjare;

- Masa 3: Investimet në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore.

Buxheti total për mbështetjen e të gjitha masave dhe nënmasave ishte 24.6 mil. €, të ndara për Masën 1 (16.8 mil. €), si dhe për Masën 3 (3.5 mil. €).

Bazuar në projektet e miratuara nga PZHR për vitin 2023, janë raportuar gjithsej 134 përfitues nga 471 aplikues sa ishin gjithsej për vitin 2023 për sektorin e perimeve, me gjithsej shumë të paraparë në vlerë 5.5 mil. €, ndërsa shuma e aprovuar për pagesë nga përkrahja publike për projektet e kontraktuara ishte në vlerë 10.7 mil. €.

Sipas të dhënave nga projektet e miratuara, shuma e paguar dhe numri i përfituesve për secilën masë që ndërlidhen me sektorin e perimtarisë ishte: për Masën 1, kishte gjithsej 125 përfitues dhe shuma e aprovuar ishte 7.3 mil. €, Masa 3, kishte gjithsej 9 përfitues dhe shuma për aprovuar ishte 3.4 mil. €. Të dhënat më të detajuara për numrin e përfituesve dhe vlerën e pagesës për projektet e miratuara për secilën nënmasë shihen në tabelën në vijim.

Tabela 28: Projektet e miratuara nga PZHR për sektorin e perimeve, 2023

<i>Masat dhe nënmasat</i>	<i>Nr. i aplikuesve</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Shuma e aprovuar (€)</i>	<i>Shuma për pagesë (€)</i>	<i>Buxheti i paraparë (€)</i>
<i>Masa 1: Investimet në asetet fizike të Ekonomive bujqësore</i>	1,251	404	25,463,489	16,453,611	16,827,000
<i>1.3 Sektori i perimeve dhe serrave, përfshirë serrat për fidane</i>	368	91	4,928,512	3,193,669	3,000,000
<i>1.4 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve</i>	76	34	2,412,206	1,512,239	1,200,000
<i>Gjithsej</i>	444	125	7,340,718	4,705,908	4,200,000
<i>Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore</i>	59	16	6,158,657	3,079,328	3,500,000
<i>3.4 Përpunimi i pemëve dhe perimeve</i>	15	2	701,076	350,538	500,000
<i>3.6 Pika grumbulluese/depo</i>	12	7	2,741,100	1,370,550	800,000
<i>Gjithsej</i>	27	9	3,442,176	1,721,088	1,300,000

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë – AZhB; *projektet e miratuara deri më datë 06.12.2024

Në kuadër të zhvillimit të sektorit të perimeve, është vërejtur një zgjerim i sipërfaqeve të kultivuara në ambiente të mbrojtura. Gjatë periudhës raportuese janë shtuar gjithsej 21.49 ha serra të reja, e cila pritët të ndikojë pozitivisht në rritjen e prodhimit, përmirësimin e cilësisë dhe zgjatjen e sezonit të kultivimit.

Të dhënat për treguesin e vendeve të punës, tregojnë se 118 përfitues nga gjithsej numri i përfituesve nga nënmasat për sektorin e perimtarisë kanë krijuar 168 vende të reja pune, ndërsa tabela në vijim paraqet në detaje numrin e vendeve të punës të pranuar, numrin e përfituesve si dhe mesataren e vendeve të krijuara nga projektet e Masës 1 dhe 3, ku vërehet se projektet e mbështetura në përpunim të pemëve dhe perimeve gjenerojnë mesataren më të lartë të punësimit, prej 5 vendeve të punës për projekt.

Tabela 29: Vendet e punës të krijuara në sektorin e perimtarisë, PZhR 2023

Nënmasa	Numri i përfituesve që kanë krijuar vende pune në nënmasat e ndërlidhura me sektorin e perimeve.	Numri i vendeve të punës të pranuar me projekt në nënmasat e ndërlidhura me sektorin e perimeve.	Mesatarja e vendeve të punës për projekt
1.3 - Sektori i perimeve dhe serrave	89	103	1.2
1.4 - Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	20	20	1.0
3.4 - Përpunimi i pemëve dhe perimeve	2	10	5.0
3.6 - Pika grumbulluese /depo	7	35	5.0
Gjithsej	118	168	1.4

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë – AZhB, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Bazuar në treguesit e gjeneruar nga PZhR për vitin 2023, të dhënat tregojnë se nga sektori i perimtarisë janë:

- 34.7% (102) nga 294 e përfituesve që kanë qenë fermer të rinj;
- 3.9% (7) nga 178 e përfituesve që investimet e tyre i kanë bërë në lokacione me lartësi mbidetare më të madhe se 700m;
- 29.7% (54) nga 182 e përfituesve që ishin ndërmarrje të reja;
- 22.5% (16) nga gjithsej 71 përfitues që kanë investuar në blerjen e traktorëve të rinj;
- 27.6% (132) nga 478 përfitues që kanë investuar në energji të ripërtërishme, dhe nga 132 përfitues që kanë investuar në energji të ripërtërshme e që janë përfitues në kuadër të nënmasave që ndërlidhen me sektorin e perimeve, është investuar në kapacite prodhuese për energji të ripërtërishme prej 730.70 kw.
- 22.5% (38) nga 169 përfitues që kanë angazhuar studentë në implementim të projekteve;

Tabela 30: Të dhëna për disa nga treguesit e gjeneruar nga PZhR 2023

Treguesit	Numri i përfituesve në të gjitha nënmasat	Numri i përfituesve në nënmasat që ndërlidhen me sektorin e perimeve
Fermer i ri	294	102
Lartësi mbidetare >700m	178	7
Ndërmarrje të reja	182	54
Investim në blerje të traktorit	71	16
Energji e ripërtërishme	478	132
Studentë të punësuar	169	38

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë – AZhB, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

5 Plotësimi i nevojave vendore dhe konsumi


Sektori i perimeve dhe rritja e prodhimit të tij janë thelbësore në strategjitë e zhvillimit të bujqësisë, dhe janë gjithashtu pjesë e programeve vjetore të mbështetjes financiare që kanë për qëllim rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës në këtë sektor. Aktualisht, Kosova është një importues neto i produkteve bujqësore, me një nivel të importit më të lartë se eksportet, duke pasur si pasojë nevojën për të importuar ushqime nga shtetet e tjera për të përmbushur kërkesat e konsumit të brendshëm. Ky hendek në balancën e prodhimit vendor dhe kërkesës për produkte bujqësore tregon një nevojë urgjente për rritjen e prodhimit të brendshëm, i cili do të mund të përmbushë më shumë nevojat e popullsisë dhe të ulë varësinë nga importet.

5.1 Plotësimi i nevojave vendore me kultura perimtare

Kosova ka rritur prodhimin e shumë produkteve bujqësore dhe ka zgjeruar rrjetin e përpunimit për të përmbushur kërkesat e konsumit vendor, si dhe për të siguruar mundësinë e eksportit në tregje të ndryshme. Një shembull i rëndësishëm është patatja, e cila tradicionalisht kultivohet nga shumë fermerë kosovarë. Plotësimi i nevojave vendore për kultura perimtare është rreth mesatares prej 78%, duke ndryshuar në periudhën 2021-2023, nga 75% deri në 79%. Kështu, Kosova siguron me prodhimin vendor afërsisht 78% të konsumit të popullsisë, ndërsa pjesa tjetër mbulohet me produkte të importuara.

Në vitin 2022, u shënuar një rritje e sipërfaqeve të mbjella me perime për 172 ha, në raport me vitin 2021, mirëpo kishte ngritje të prodhimit prej 13,068 tonë më shumë perime sesa në vitin 2021. Në vitin 2022, u shënuar një rënie në importin e prodhimeve perimtare për rreth 14 mijë tonë, si dhe një rritje e eksportit për rreth 3 mijë tonë të kulturave perimtare, dhe kjo ndikoi në rritje të shkallës së vetëmjaftueshmërisë për 5 pikë të përqindjes, nga 75% në vitin 2021, në 80% në vitin 2022.

Figura 92: Furnizimi me kultura të perimeve, 2021-2023



Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Rritje të mbjelljes së sipërfaqeve të përgjithshme për 31 hektar, kishte në vitin 2023 në raport me vitin 2022, mirëpo u shënua një rënie prej 7,982 tonë më shumë prodhim dhe rritje të importit të kulturave perimtare për 1.8 mijë tonë si dhe ngritje të eksportit për 1.3 mijë tonë, që rezultoi me rënie të shkallës së vetëmjaftueshmërisë me 1 pikë përqindje, në krahasim me vitin 2022.


5.1.1 Plotësimi i nevojave vendore për kulturat perimtare më të kultivuara

Nga kulturat perimtare më të kultivuara gjatë vitit 2023, në vendin tonë ishin: patatja, speci, fasulja, kungulli, kungulli i misirit, qepa, shalqiri, lakra, domatja dhe trangulli.

Prej analizës së bërë për secilën kulturë të lartëcekur vërehet se mbështetja financiare për sektorin e perimeve që është bërë, qoftë përmes PPD-së apo PZHR-së, ka ndikuar që Kosova të arrijë të plotësojë nevojat për konsum mbi 50%. Shkalla më e ulët e vetëmjaftueshmërisë paraqitet te kultura e domates, shalqirit dhe fasules, ndërkaq shkallë më të lartë të vetëmjaftueshmërisë shënojnë kultura e kungullit dhe kungullit të misirit, patates, specit dhe lakrës.

Kultura perimtare përmes së cilës Kosova njihet për kultivimin e saj është kultura e patates e cila në periudhën 2021-2023 kishte sasi të importit (në kg) më të lartë sesa sasi të eksportit, ndërkaq në vitin 2023, sasia e eksportuar ishte më e lartë sesa sasia e eksportuar për vitet 2022 dhe 2021. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë për kulturën e patates rritet për 4 pikë përqindje, në krahasim me vitin 2022, vendi ynë ka shkallë të lartë të vetëmjaftueshmërisë në plotësimin e nevojave të popullsisë me këtë kulturë, prej 98% të konsumit.

Figura 93: Furnizimi me patate, 2021-2023




Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Kultura e specit është e dyta që renditet në mesin e kulturave që ka shkallë të lartë të vetëmjaftueshmërisë e cila në periudhën 2021-2023 kishte rënie të sasisë së eksportit (në kg)

por sasia e importit është dukshëm më e lartë, mirëpo gjithsesi arrihet që të plotësohen nevojat e popullsisë për konsum deri në 82% me këtë kulturë.

Në vitin 2023, shkalla e vetëmjaftueshmërisë së kulturës së specit u ul për 5 pikë përqindje, në krahasim me vitin 2022, si rezultat i uljes së prodhimit dhe rritjes së importit, gjithashtu në vitin 2023, u shënuar rënie e eksportit të kësaj kulture për 320 tonë në krahasim me vitin 2022.


Figura 94: Furnizimi me spec, 2021-2023



Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Kultura e fasules është në mesin e kulturave të cilat kanë shkallë mesatarisht të lartë të vetëmjaftueshmërisë, me ulje për 3 pikë % në vitin 2023. Nga 55% sa ishte në vitin 2021, ka pasur një rritje në 56%, në vitin 2022, por në vitin 2023, kemi prapë rënie në 53%, që nënkupton se në vitin 2023, është regjistruar rënie e prodhimit të kësaj kulture, rritje e sasisë së importuar për 267 tonë në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, si dhe një rritje e sasisë së eksportuar për 76 tonë më shumë në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022.


Figura 95: Furnizimi me fasule, 2021-2023



Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Prej kulturave të cilat i përmbushin nevojat e popullsisë për konsum në vitin 2023, janë kultura e kungullit dhe kungullit të misirit. Këto kultura, në periudhën 2021-2023, kanë shkallën e vetëmjaftueshmërisë më të lartë nga të gjitha kulturat tjera, me 100%. Nëpër vite kjo kulturë ka shënuar rënie të prodhimit si dhe rënie të vlerës së importuar, por edhe të asaj të eksportit që nënkupton se në përgjithësi ka rënë interesimi për konsumimin e kësaj kulture.

Figura 96: Furnizimi me kungull dhe kungull misiri, 2021-2023




Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Kultura e qepës në vitin 2023, u prodhua në sasi prej 19,012 tonë, u importua në sasi prej 6,563 tonë, dhe u eksportua në një sasi të konsiderueshme me 656 tonë. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimi të nevojave vendore për konsum të qepës me

prodhim vendor ishte 76%, apo 5 pikë përqindje më e lartë sesa në vitin 2022. Sasia e eksportit të kulturës së qepës kishte ngritje prej 35% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022.


Figura 97: Furnizimi me qepë, 2021-2023



Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Kultura e shalqirit është kultura e cila arrin që të plotësojë 59% të nevojave për konsum të përgjithshëm të popullsisë. Edhe pse konsiderohet kulturë stinore, kjo kulturë shënoi rënie të prodhimit për 1,867 tonë, rënie të importit për 3% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, si dhe rënie të madhe të eksportit për 86% në vitin 2023. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë së kësaj kulture ndër vite ka shënuar ngritje, nga 51% sa kishte në vitin 2021, në 60% në vitin 2022, dhe në vitin e fundit 2023 ka rënë në 59%.


Figura 98: Furnizimi me shalqi, 2021-2023



Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Kultura e lakrës është në mesin e kulturave perimtare e cila ka shkallë mesatarisht të kënaqshme të vetëmjaftueshmërisë, me 84% të plotësimit të nevojave vendore për konsum. Eksporti i kësaj kulture shënon një rënie të konsiderueshme po ashtu edhe sasia e importuar kishte rënie prej 30%.

Figura 99: Furnizimi me lakër, 2021-2023




Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Edhe pse shkalla e vetëmjaftueshmërisë për kulturën e lakrës është e kënaqshme, ndër vite kjo kulturë ka shënuar rënie në pikë përqindje nga 85% sa ishte në vitin 2021, në 84% në vitin 2022, dhe në vitin 2023.

Kultura e domates, është kultura e cila ka shkallë më të ulët të vetëmjaftueshmërisë në raport me të gjitha perimet e tjera që hyjnë në grupin e perimeve më të kultivuara në Kosovë. Ndër vite, kjo shkallë ka regjistruar një ngritje në 10 pikë përqindje në vitin 2022, në raport me vitin 2021 dhe një rënie në 6 pikë të përqindjes në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022.


Figura 100: Furnizimi me domate, 2021-2023



Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Kultura e trangullit, është kulturë e cila shkallën e vetëmjaftueshmërisë e ka deri diku të kënaqshme. Kjo kulturë, pavarësisht rënies së sasisë së prodhimit në vitin 2023, kishte rënie po ashtu edhe tek importi (8%), si dhe rënie ka pësuar edhe sasia e eksportuar për 45% në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022.

Figura 101: Furnizimi me trangull, 2021-2023



Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore për konsum të trangullit me prodhim vendor në vitin 2021 ishte 64%, ndërsa në vitin 2022 dhe në vitin 2023, ishte 63%, me 1 pikë të përqindjes më të ulët sesa në vitin 2021.


5.2 Konsumi për kokë banori

Nga të dhënat për periudhën 2021-2023, vërehet se konsumi i perimeve ka shënuar rritje në vitin 2023, për 15 kg më shumë sesa në vitin 2022, dallimin më të madhe kanë kultura e specit dhe patates të cilat janë konsumuar për 5 kg, përkatësisht 3 kg më shumë sesa në vitin 2022.

Në vitin 2023, konsumi i perimeve vlerësohet të ketë rreth 224 kg në vit për kokë banori, përderisa në vitin 2022, ky konsum u vlerësua të jetë rreth 208 kg, dhe në vitin 2021, rreth 209 kg në vit për kokë banori.

Kemi pasur rritje të konsumit të perimeve në vitin 2023, për 15 kg më shumë se sesa në vitin 2022, ky ndryshim pozitiv është i rëndësishëm dhe mund të jetë rezultat i ndërgjegjësimit më të madh për rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm, si dhe përmirësimeve në furnizim dhe prodhim bujqësor.

Figura 102: Konsumi i perimeve për kokë banori, 2021-2023




Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Prej 10 kulturave perimtare që kultivohen në Kosovë në sipërfaqe më të madhe, konsum më të lartë për kokë banori në vitin 2023, ka patatja me 48 kg në vit, speci me 41 kg, shalqiri me 27 kg, kungulli dhe kungulli i misirit me 26 kg⁶, pasuar nga domatja me 22 kg, lakra me 19 kg, qepa me 16 kg, trangulli me 9 kg dhe fasule me 6 kg.

Ndryshe nga perimet e cekura më sipër, në vitin 2023, perime të tjera janë konsumuar rreth 11 kg, në vitin 2022 dhe në vitin 2021, rreth 10 kg për kokë banori.

⁶ Kjo përfshinë sasinë totale të prodhimit dhe sasinë e importuar dhe eksportuar duke pjesëtuar me numrin e banorëve, dhe kjo është bërë në mungesë të të dhënave për konsum të kungullit si ushqim për kafshë.

Figura 103: Konsumi i perimeve sipas kulturave, 2021-2023



Burimi: ASK - Anketa e Ekonomive Bujqësore ('21,'22,'23), Të dhënat e tregtisë, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Konkluzionet

Bujqësia konsiderohet si njëra ndër degët kyçe të ekonomisë së Kosovës, e sidomos sektori i kulturave perimtare. Zhvillimit të këtij sektori i është kushtuar vëmendje e posaçme, sidomos viteve të fundit, duke u përqendruar në aspektin e subvencionimit të fermerëve, këshillimit të tyre dhe krijimit të lehtësirave të tjera si në aspektin teknik po ashtu edhe atë legjislativ.

Kthimi i vëmendjes së bujqve kah kultivimi i kulturave perimtare ka bërë që vazhdimisht të mbillen sipërfaqe të reja me kultura të ndryshme perimtare dhe konsiderohet se çdo vit mesatarisht shtohen ose rriten rreth 0.9%⁷ sipërfaqe të reja. Në raport me këtë aspekt ka ndikuar mbështetja financiare ndër vite që ka ndarë Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Programeve të MBPZHR-së për Pagesa Direkte dhe për Projektet e Zhvillimit Rural.

Me mbështetje financiare iu është mundësuar bujqve që përveç subvencionimit për hektarët e mbjellë të përfitojnë edhe nga masat përkatëse të PZHR-ve, si: mekanizëm bujqësor, sistemin e ujitjes, ndërtimin e serrave moderne, etj. Kjo ka ndikuar në tejkalimin më të shpejtë të vështirësive financiare që mund të paraqiten tek bujqit me rastin e mbjelljes së sipërfaqeve të reja por edhe në modernizimin e sistemit të punës.

Përveç vështirësive financiare, fermerët përballen edhe me sfidën e kushteve atmosferike, të cilat thuhet se çdo vit bëjnë që të dëmtohen sipërfaqe të mëdha me të mbjella pavarësisht përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së parcelave.

Tregtia për sektorin e perimeve në periudhën 2021-2023, eksporti (sipas sasisë) i kulturave perimtare pati një rritje prej 26% në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021, po ashtu edhe në vitin 2023, kishte rritje për 10%, në krahasim me vitin 2022. Kulturat të cilat u eksportuan në sasi të mëdha dhe pa ndërprerje gjatë gjithë vitit 2022, ishin patatja dhe kerpudha ndërsa specit dhe trangullit u eksportuan në sasi të mëdha gjatë periudhës së vjeljes së tyre. Krahas rritjes së sasisë së eksportuar në vitin 2022, ka rënie në sasinë e importit në vitin 2022 për 14%, në krahasim me vitin 2021, e cila pastaj vazhdoi me ngritje në vitin 2023 për 2%, në krahasim me vitin 2022.

Në vitin 2022, vërehet ngritje e përgjithshme e çmimeve, e cila vazhdon tek disa kultura edhe në vitin 2023, por për dallim nga viti 2022 që kishte rritje tek të gjitha kulturat perimtare në vitin 2023 çmimet e disa kulturave perimtare shënuar rënie. Pavarësisht rritjes së çmimeve të disa kulturave perimtare në vitin 2023, konsumi i tyre është rritur dhe duke marr parasysh se këtë vit kishte sasi më të ulët të prodhimit, kërkesa në rritje për konsum dhe oferta apo sasia në dispozicion më e ulët kanë ndikuar në rritje të disa prej çmimeve. Gjithashtu, pjesë përbërëse e rritjes së çmimeve janë edhe ngritja e çmimeve të produkteve të energjisë, të gazit dhe derivateve të ndryshme.

⁷ Kalkulim në bazë të mesatares të % së rritjes në periudhën 2020-2023.

Shkalla e vetëmjaftueshmërisë në vitin 2023, shënon një rënie për 1 pikë të përqindjes në raport me vitin 2022, si rezultat i kushteve të pafavorshme klimatike të cilat ndikuan drejtpërsëdrejti në rënie të rendimentit dhe prodhim, duke bërë që të ketë mesatarisht 3% më pak sasi të prodhuar për vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, ndërsa në vitin 2022, prodhimi ishte 5% më i lartë se sa në vitin 2021.

Në përfundim të kësaj analize, del se është e domosdoshme që politikat mbështetëse të qeverisë të fokusohen drejtpërdrejt aty ku ndikon më shumë tek bujku. Kjo përfshin: lehtësimin e kushteve për përfitim nga programet ekzistuese mbështetëse, hartimin e politikave të reja që përkrahin sektorin, subvencionimin e sigurimit për kulturat bujqësore, ndarjen e subvencioneve të veçanta për kulturat me mungesë në treg, si dhe orientimin drejt krijimit të kapaciteteve të reja për ruajtjen e kulturave perimtare në depo të përshtatshme. Po ashtu, është thelbësore që politikat të synojnë përkrahjen financiare për mekanizimin bujqësor – proces i cili jo vetëm që ndihmon në rritjen e efikasitetit, por edhe zbut ndikimin e mungesës së fuqisë punëtore, e cila po zvogëlohet ndjeshëm si në Kosovë, ashtu edhe në rajon.

Duke parë zhvillimet dhe ndryshimet klimatike është e nevojshme që në programet mbështetëse të përfshihen edhe masa të caktuara që adresojnë adaptimin dhe mbrojtjen nga efektet e ndryshimeve klimatike. Gjithashtu mbështetja për teknologji të reja dhe digjitalizim duhet të jetë pjesë përbërëse e politikave mbështetëse për të përmirësuar procesin e prodhimit dhe përdorimin sa më efikas të inputeve.

Shtojca

Tabela 31: Lista e kodeve doganore (8 shifrore) të përfshira në analizë tek kapitulli i tregtisë

Kultura	Kodi doganor	Përshkrimi i kodit doganor
Asparagu	07092000	Shparg i freskët apo i ftohtë
	07108085	Shparg, qoftë apo jo i gatuar, i gatuar në avull apo i zier në ujë, i ngrirë
Brokoli dhe Lulelakër	07041000	Lulelakra dhe brokoli, të freskëta ose të ftohta
	07041010	Lulelakër dhe lulelakër e llojit brokoli
	07041090	Lulelakër dhe lulelakër e llojit brokoli
Domate	07020000	Domate, të freskëta ose të ftohta
	07108070	Domate, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë, të ngrira
	07129030	Domate të thara, të plota, të prera, në feta, të shtypura ose në formë pluhuri, por jo më tej të përgatitura
Fasule	07082000	Fasule e freskët apo e ftohtë "Vigna spp., Phaseolus spp.", me apo pa lëvozhgë
	07102200	Fasule "Vigna spp., Phaseolus spp.", me apo pa lëvozhgë, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë, të ngrira
	07133100	Fasule të llojit "Vigna mungo [L.] Hepper apo Vigna radiata [L.] Wilczek", të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara
	07133200	Fasule "Adzuki" "Phaseolus apo Vigna angularis" të vogla të kuqe, të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara
	07133390	Fasule të kuqe "Phaseolus vulgaris", të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara (përveç asaj për mbjellje)
	7133400	Fasule e thatë, me lëvozhgë "Vigna subterranea apo Voandzeia subterranea", qoftë me lëvore, e ndarë ose jo
	07133900	Fasule "Vigna dhe Phaseolus", të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara (përveç fasuleve të llojit "Vigna mungo [L.] Hepper apo Vigna radiata [L.] Wilczek", fasuleve të vogla të kuqe "Adzuki", fasuleve të kuqe, fasuleve Bambara dhe biz
	7135000	Bathe të thara me lëvozhgë (Vicia faba var. major) dhe bathe kuajsh (Vicia faba var. equina, Vicia faba var. minor), qofshin me lëvore, të ndara ose jo
Hudhër	07032000	Hudhra, të freskëta ose të ftohta
Karotë dhe Rrepë	07061000	Karota dhe rrepa të freskëta ose të ftohta
	07129050	Karota të thara, të plota, të prera, në feta, të shtypura ose në formë pluhuri, por jo më tej të përgatitura
Kungull dhe Kung. misiri	07099390	Kungull, kungull misri dhe kungull dekorativ "Cucurbita spp.", të freskët apo të ftohtë (përveç kungujve të vegjël)
Kungulleshka	07099310	Kungull i vogël, i freskët ose i ftohtë
Lakër	07042000	Lakër Bruksel, e freskët ose e ftohtë
	07049010	Lakra të bardha dhe të kuqe, të freskëta ose të ftohta
	07049090	Lakra rrepe (kolerabi), lakra gjethe dhe produkte Brassica të ngjashme të ngrënshme, të freskëta apo të ftohta (përveç lulelakrave, brokollit, lakrës Bruksel, lakrës së bardhë dhe të kuqe)
Panhxhar	07069030	Rrepa pikante e freskët apo e ftohtë "Cochlearia armoracia"
	07069090	Panhxhar i kuq për sallatë, rrepë e zezë, rrepa pikante dhe rrënjë të ngjashme të ngrënshme të freskëta apo të ftohta (përveç karotave, rrepave, zhardhokut të selinos dhe rrepës pikante)
	07099920	Rrepa e "panxharit të bardhë" dhe gjembaçi, të freskët ose të ftohtë
	7019010	Patate për prodhimin e niseshtesë, të freskëta ose të ftohura
	07019050	Patate të reja të freskëta ose të ftohta nga 1 janari deri më 30 qershor

Patate	07019090	Patate, të freskëta ose të ftohta (përveç patateve të reja nga 1 janari deri më 30 qershor, farës së patates dhe patates për prodhimin e niseshtesë)
	07101000	Patate, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë, të ngrira
	07129005	Patate të thara, qofshin apo jo të prera ose në feta, por jo më tej të përgatitura
Patëllxhan	07093000	Patëllxhanë të freskët apo të ftohtë
Presh	07039000	Presh dhe perime të tjera të llojit allium, të freskëta ose të ftohta (përveç qepëve, qepëve të ëmbla dhe hudhrave)
Qepë	07031019	Qepë, të freskëta ose të ftohta (jo në tufa)
	07031090	Qepë të ëmbla, të freskëta ose të ftohta
	07119050	Qepë të ruajtura përkohësisht, p.sh. me gaz dioksid sulfuri, në ujë të kripur, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për ruajtje, por të papërshtatshme për konsum të menjëhershëm në atë gjendje
	07122000	Qepë të thara, të plota, të prera, në feta, të shtypura ose në formë pluhuri, por jo më tej të përgatitura
Sallata	07051100	Marule e freskët ose e ftohtë e lakrës
	07051900	Marule e freskët apo e ftohtë (përveç maruleve të lakrave)
	07052100	Çikore e freskët apo e ftohur
	07052900	Cikore e freskët apo e ftohtë (përveç cikores witloof)
	07099910	Perime të freskëta ose të ftohta për sallatë (përveç maruleve dhe cikoreve)
Spec	07096010	Specat të freskët ose të ftohtë
	07096091	Fruta të freskëta ose të ftohta të gjinisë Capsicum, për prodhimin e ngjyrave capsicin apo capsicum oleoresin
	07096095	Fruta të freskëta ose të ftohura të llojit Capsicum ose Pimenta për përpunimin industrial të vajrave esenciale apo të rezinave
	07096099	Fruta të freskëta ose të ftohta të gjinisë Capsicum ose Pimenta (përveç atyre për prodhimin e ngjyrave capsicin ose capsicum oleoresine, për përpunimin industrial të vajrave esenciale apo të rezinave, dhe specave)
	07108051	Specat të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të zier në ujë, të ngrirë
	07108059	Fruta të llojit Capsicum apo të llojit Pimenta, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të zier në ujë, të ngrirë (përveç specave)
	07119010	Fruta të llojit Capsicum ose Pimenta të ruajtura përkohësisht, p.sh. me gaz dioksid sulfuri, në ujë të kripur, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për ruajtje, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje (përveç specit të ëmbël)
Spinaq	07097000	Spinaq, spinaq i Zelandës së Re dhe spinaq i kuq (orache) i freskët apo i ftohtë
	07103000	Spinaq, spinaq i Zelandës së Re dhe spinaq i kuq (orache), i pa gatuar ose i gatuar me avull apo i zier në ujë, i ngrirë
Trangull	07070005	Tranguj, të freskët apo të ftohtë
	07070090	Kastravecë të vegjël, të freskët apo të ftohur
	07114000	Tranguj dhe kornishon të vegjël, të konservuar përkohësisht, p.sh. me dyoksid sulfuri në gjendje të gaztë, në shëllirë, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për konservim, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje
Misër i ëmbël	07099960	Misër i ëmbël i freskët ose i ftohtë
	07104000	Misër i ëmbël, i pa gatuar ose i gatuar me avull apo i zier në ujë, i ngrirë
	07119030	Misër i ëmbël, i konservuar përkohësisht, p.sh. me dyoksid sulfuri në gjendje të gaztë, në shëllirë, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për konservim, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje
	07129011	Misër i ëmbël i thatë, hibrid, për mbjellje
	07129019	Misër i ëmbël i thatë "Zea mays var. saccharata", qofshin të prera, të prera në feta ose jo, por të përgatitura më tutje (përveç hibridëve për mbjellje)
	07095100	Kërpudha të freskëta apo të ftohta të llojit "Agaricus"
	07095910	Chantërelles të freskëta apo të ftohura

Kërpudha	07095930	Kërpudha Flap të freskëta apo të ftohura
	07095950	Zhardhokë kërpudhash (Tartufi) i freskët apo i ftohur
	07095990	Kërpudha të ngrënshme të freskëta ose të ftohta (përveç kërpudhave chanterelles, kërpudhave flap, kërpudhave të llojit "Agaricus" dhe zhardhokëve të kërpudhave (tartufit)
	07108061	Kërpudha të llojit Agaricus të ngrira, të pagatuara ose të gatuar me avull apo me valë
	07108069	Kërpudha të ngrira, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë (përveç llojit Agaricus)
	07115100	Kërpudha të llojit "Agaricus", të ruajtura përkohësisht, p.sh. me gaz dioksid sulfuri, në ujë të kripur, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për ruajtje, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje
	07115900	Kërpudha dhe zhardhokë kërpudhash (Tartufi), të ruajtur përkohësisht, p.sh. me gaz dioksid sulfuri, në ujë të kripur, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për ruajtje, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje (përveç kërpudhave të llojit "Agaricus")
	07123100	Kërpudha të thara të llojit "Agaricus", të plota, të prera, në feta, të shtypura ose në formë pluhuri, por jo më tej të përgatitura
	07123200	Wood ears "Auricularia spp." të thatë, të plotë, të prerë, në feta, të shtypur ose pluhur, por të papërgatitur më tutje
	07123300	Jelly fungi "Tremella spp." të thatë, të plotë, të prerë, të prerë në feta, të shtypur ose pluhur, por të papërgatitur më tutje
	07123900	Kërpudha dhe zhardhokë kërpudhash (Tartufi) të thara, të plota, të prera, në feta, të shtypura ose në formë pluhuri, por jo më tej të përgatitura (përveç kërpudhës së llojit "Agaricus", kërpudhës së zezë kineze "Auricularia spp." dhe kërpudhës jelly "Trem
	07095200	Kërpudha të llojit Boletus
	07095300	Kërpudha të llojit Cantharellus
	07123400	Shiitake (Lentinus edodes)
	07095600	Zhardhoka (Tuber spp).
	07095900	Të tjera
	07069010	Zhardhok të freskët apo të ftohtë të selinos "selino me rrënjë apo selino Gjermane"
	07081000	Bizele e freskët apo e ftohur "Pisum sativum", me apo pa lëvozhgë
	07089000	Perime leguminoze të freskëta apo të ftohta, me apo pa lëvozhgë (përveç bizeles "Pisum sativum" dhe fasules "Vigna spp., Phaseolus spp.")
	07094000	Selino e freskët apo e ftohtë (përveç zhardhokëve të selinos)
	07099100	Angjinare të freskët apo të ftohur
	07099210	Ullinj të freskët ose të ftohtë (përveç ullinjve për prodhim të vajit)
	07099290	Ullinj të freskët ose të ftohur për prodhim të vajit
	07099940	Kopër i freskët ose i ftohtë
	07099950	Kopër i freskët ose i ftohtë
	07099990	Perime të freskëta ose të ftohta, të paspecifikuara diku tjetër
	07102100	Bizele (Pisum sativum) me apo pa lëvozhgë, të pa gatuar ose të gatuar me avull të ziera në ujë, të ngrira

Perime të tjera	07102900	Perime leguminoze, me apo pa lëvozhgë, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë, të ngrira (përveç bizeles dhe fasules)
	07108010	Ullinj, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo me valë, të ngrirë
	07108080	Angjinare, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë, të ngrira
	07108095	Perime, qofshin apo jo të gatuar me avull apo të ziera në ujë, të ngrira (përveç patateve, perimeve leguminoze, spinaqit, spinaqit të Zelandës së Re, spinaqit të kuq (orache), misrit të ëmbël, ullinjve, frutave të gjinisë Capsicum ose të gjinisë Pimenta,
	07109000	Përzierje e perimeve, të pa gatuar ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë, të ngrira
	07112010	Ullinj të ruajtur përkohësisht, p.sh. me gaz dioksid sulfuri, në ujë të kripur, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për ruajtje, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje (përveç për prodhim vajit)
	07112090	Ullinj të konservuar përkohësisht, p.sh. me dyoksid sulfuri në gjendje të gaztë, në shëllirë, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për konservim, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje, për prodhim të vajit
	07119070	Sythe të bimës kopër (Capers) të ruajtura përkohësisht, p.sh. me gaz dioksid sulfuri, në ujë të kripur, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për ruajtje, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje
	07119080	Perime të konservuara përkohësisht, p.sh. me dyoksid sulfuri në gjendje të gaztë, në shëllirë, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për konservim, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje (përveç ullinjve, koperi, trangujve)
	07119090	Përzierje perimesh të konservuara përkohësisht, p.sh. me dyoksid sulfuri në gjendje të gaztë, në shëllirë, në ujë të sulfurit ose në tretësira të tjera për konservim, por të papërshtatshëm për konsum të menjëhershëm në atë gjendje
	07129090	Perime dhe përzierje perimesh, të thara, të plota, të prera, në feta, të shtypura ose në formë pluhuri, por jo më tej të përgatitura (përveç patateve, qepëve, kërpudhave, zhardhokëve të kërpudhave (tartufit), misrit të ëmbël, domateve dhe karotave)
	07131090	Bizele, "Pisum sativum", të thara dhe me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara (përveç bizeleve për mbjellje)
	07132000	Qiqra "garbanzos" të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara
	07133500	Bizele me lëvozhgë, e llojit cow peas "Vigna unguiculata", qoftë me lëvore, e ndarë ose jo
	07134000	Thjerrëza të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara
	07136000	Bizele pigeom, "Cajanus cajan", të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara
	07139000	Perime leguminoze, të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara (përveç bizeleve, qiqrave, fasules, thjerrëzave, bathës, bathës së kuajve dhe bizeleve të llojit pigeon)
	07142010	Patate të ëmbla, të freskëta, të plota, për konsum njerëzor
	07142090	Patate të ëmbla, të freskëta, të ftohura, të ngrira apo të thara, qofshin të prera në feta ose jo apo në formë të sferave (përveç patateve të ëmbla, të freskëta, të plota, për konsum për njerëz)
	07149090	Angjinare, rrënjë dhe zhardhokë të ngjashëm të Jerusalemit me përmbajtje të lartë inuline, të freskëta, të ftoha, të ngrira apo të thara, të prera njëtrajtshëm apo në formë të peletave, dhe palcë e palmës e imtësuar (përveç manioc, rrënjës-arrow, salepit,
	07143000	Patate të llojit Yams (Dioscorea spp.) , të freskëta, të ftohura, të ngrira apo të thara, qofshin të prera në feta ose jo apo në formë të sferave
	07149020	Rrënjë dhe zhardhoke te arrow, salepit e të ngjashme, me përmbajtje të larte niseshteje
Farë për mbjellje të perimeve	07011000	Farë e patates
	07031011	Tufë qepësh, të freskëta ose të ftohta
	07131010	Bizele, "Pisum sativum", të thara dhe me lëvozhgë, për mbjellje
	07133310	Fasule të kuqe "Phaseolus vulgaris", të thara, me lëvozhgë, qofshin apo jo të qëruara ose të ndara